

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7487 E martë 3 Prill 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Të rrallë e unikë mund të kenë qenë ata, që kishin imagjinuar të shihnin një protestë të qytetarëve për veten e tyre, siç ishte rasti i banorëve kuksianë, që ...
Vijon në faqen 20

Nga MIMOZA KOÇIU

Kompleksimi pervers i një proteste qytetare



Opinion i Ditës

Kur e përditshmja më e madhe në vend, "THE ARIZONA DAILY STAR", gazeta që publikohet në Arizonën Jugore të Shteteve të Bashkuara ...
Vijon në faqen 21

Nga MONIKA STAFA

"Chatbots" - drejt një marrëdhënie mes palësh me audiencat



Protesta në Tiranë për lirimin e kuksianëve

Taksa për Rrugën e Kombit, procedim avokatit: Cenohej edhe liria e fjalës

Opozita e bashkuar, Basha: Mosbindje civile me të gjitha format

Nga INA ALLKANJARI

Protesta për taksën e Rrugës së Kombit u zhvendos dy ditë më parë në kryeqytet, kjo pas transferimit të 23 të arrestuarve në Drejtorinë e Policisë së Tiranës. Me pretendimin se kanë tubuar në mënyrë të paligjshme...

Në faqet 2-5

DREJTORIA E TATIMEVE SHPJEGON PROCEDURËN E TAKSIMIT, JA DOKUMENTET QE DUHEN PLOTESUAR

11.500 BIZNESE TE VOGLA, SI DO ZBATOHET "TVSH-JA"

MF: Qarkullim vjetor mbi 2 milionë lekë të vit. Duhet të fillojnë të mbajnë inventar, të marrin faturë tatimore për çdo blerje që bëjnë



(Në foto) Biznes i vogël (foto ilustruese)

Në faqen 9

RREFIMI NE POLICI: S'E DI Ç'KAM BERE



Vret shokun me thikë në zemër pas sherrit në lokal, prangoset 27-vjeçari i dehur

Në faqen 8

Raporti i Fullanit: U desh ndërhyrja e shokut Enver që vëllimi të mos shkonte te lexuesit

"Shuteriqi lejoj botimin me ndikime dekadente të Arapit"

Si spiunonin miqtë njëri-tjetrin, libri i ri i Kaloçit nxjerr të palarat

Nga DASHNOR KALOÇI

Mënjëherë pas fjalimit të Enver Hoxhës më 15 dhe 16 mars të vitit 1973 në aparatën e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, ku si temë kryesore ishte: "Lufta kundër shfaqjeve të huaja dhe lib-



erale në art, kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vendit", ashtu siç kemi parë edhe në mjaft nga kapitujt e tjerë të këtij libri, në të gjitha institucionet kulturore dhe artistike të vendit, organizatat bazë dhe komitetet ...

Në faqet 12-13

DITA E KUJTESËS

Viktimit e komunizmit, zbardhet shkresa e PD për Gramoz Ruçin, 9 deputetët që u tërhoqën

Në faqen 7

MINISTRIA E SHENDETËSISË

Pagesa e KEMP-it, jo më rikomisionim për fëmijët me autizëm, ja sa do të paguhet

Në faqen 10

LISTA E VI

Vendimet e vitit '97, emrat e 1462 pronarëve që do të kompensohen

Në faqet 14-16

TEATRI

Artistët në protestë, Ndrenika për teatrin: Rama të na lërë të qetë

Në faqen 18

RRUGA E KOMBIT PROTESTA

Taksa e Rrugës së Kombit, të ndaluarit merren në pyetje, nesër para gjykatës

Arrestimet në Kukës, qytetarët protestojnë përpara Drejtorisë së Policisë në kryeqytet

Tubuesit: S'keni pranga mjaftueshëm për të gjithë ne

Ina Allkanjari

Lironi vëllezërit tanë". Kështu janë shprehur ditën e djeshme dhjetëra protestues të mbledhur përpara Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Kundërshtimi i vendosjes së tarifës në Rrugën e Kombit, që u shoqërua me protesta të dhunshme dhe arrestimi i 23 personave në Kukës ka ngjallur reagime të shumta në kryeqytet. Familjarë të protestuesve të ndaluar nga policia dhe qytetarë të shumtë me pankarta në duar janë mbledhur për të kërkuar lirimin e njerëzve të arrestuar. Që prej orëve të para të mëngjesit të ditës së hënë protestuesit kanë bllokuar aksin rrugor përpara Drejtorisë së Policisë, duke ndaluar qarkullimin e automjeteve. "Liri për Kukësin", "Poshtë shteti policor", "Ju s'keni pranga mjaftueshëm për të gjithë ne", "Kur dhuna bëhet ligj, liria është afër", "Demokracia ndodhet në rrugë" janë disa prej shkrimeve që gjenden nëpër rrugë të Tiranës. Përmes tyre, qytetarët i bëjnë thirrje policisë të lihen të lirë personat që protestuan në Rrugën e Kombit, duke e cilësuar kauzën e tyre për heqjen e tarifës për përdoruesit e rrugës, të drejtë. Ndërkohë, ditën e djeshme prokurorët e Kukësit mbërritën në mjediset e Drejtorisë së Policisë së Tiranës për të pyetur të arrestuarit për ngjarjen e së shunës në Rrugën e Kombit. Seancat e pyetjeve janë bërë në Drejtorinë e Policisë së Tiranës dhe në komisaritetin numër 1 dhe numër 3. Mësohet se asnjë prej të arrestuarve nuk ka pranuar se ka kryer dhunë. Prokurorët e çështjes do të dërgojnë kërkesat e tyre në gjykatën e Kukësit, ku do të mbahet edhe seanca për të arrestuarit.

PROTESTA

Protesta në kryeqytet nisi ditën e diel rreth orës 19.00, ku dhjetëra qytetarë i bënin thirrje policisë dhe kryeministrit për të liruar të arrestuarit. Tensionet u përshkallëzuan kur qytetarët ten-




PROCEDIMI PENAL

Ndërsa kërkonin lirimin e 23 të arrestuarve, qytetarët protestuan me pankarta në dorë dhe me thirrjet "Rama ik". Por, policia nuk e ka gjykuar të drejtë veprimin e tetë prej protestuesve, duke nisur procedim penal ndaj tyre.

"Urdhër ndalimet, të motivuara politikisht"

Arrestimi i 23 protestuesve, Këshilli Bashkiak i Kukësit padit prokurorët dhe policët, ja 4 akuzat

KUKËS - Këshilli Bashkiak i Kukësit ka paditur prokurorët dhe policët që kanë lëshuar dhe ekzekutuar 23 urdhër arrestet për protestuesit në Rrugën e Kombit. Sipas këshilltarëve, mbi këta zyrtarë rëndojnë katër vepra penale të kryera në bashkëpunim dhe konkretisht: "Heqja e paligjshme e lirisë" (neni 110), "Shpërdorimi i detyrës" (neni 248), "Kryerja e veprimeve arbitrare" (neni 250) dhe "Mosmarrja e masave për të ndërprerë gjendjen e paligjshme" (neni 251). Në padinë e këshilltarëve kuksianë thuhet se ndalimet janë kryer sipas metodave që ndjekin regjimet totalitare, duke shkelur të gjitha standardet dhe parimet që sank-




sionohen në Kushtetutë. "Urdhërat e ndalimit janë ekzekutuar duke hyrë dhunshëm dhe duke ndaluar qytetarët në harkun kohor 02.00-3.30 të mëngjesit", - thuhet në padi. Këshilltarët e Bashkisë së Kukësit besojnë se urdhër arrestet janë lëshuar me një akt të motivuar politikisht nga organi i

Prokurorisë në Kukës, që nuk ka kryer procedurë të hetimit të pavarur dhe të paanshëm. "Nxjerrja pa kryer asnjë verifikim apo hetim e urdhrave të ndalimit është bërë me qëllimin kriminal të frikësimit të banorëve dhe intimidimit të tyre për të mos ushtruar të drejtën kushtetuese të tubimit dhe lirisë së shprehjes", - thuhet në padinë e këshilltarëve. Këshilltarët i qëndrojnë bindjes se qytetarët protestuan në mënyrë të ligjshme kundër padrejtësisë së qeverisë, që i grabiti ata nëpërmjet takses 10 euro vajtje0ardhje për autoveturat dhe 45 euro për kamionet, prandaj kanë hequr pikat e ndalesës dhe pagesës të vendosura në pronën publike.

tuan të futen në godinën e Drejtorisë së Policisë. Ndërsa kërkonin lirimin e 23 të arrestuarve, qytetarët protestuan me pankarta në dorë dhe me thirrjet "Rama ik". Por, policia nuk e ka gjykuar të drejtë veprimin e tetë prej protestuesve, duke nisur procedim penal ndaj tyre. Mate-

rialet u referuan në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, për shtetasit A.T., A.L., G.Gj., B.P., B.Gj., E.P., E.H., dhe A.K.. Më herët Prokuroria e Kukësit lëshoi 23 urdhër arreste për protestuesit, të cilët u përleshën me forcat e rendit dhe u vunë flakën

sportelevë të bileteve që do të mblidhin taksat për Rrugën e Kombit. Pas zbatimit të urdhrave të arresteve, të ndaluarit u zhvendosën në komisaritet në Tiranë. Shkak i kësaj zhvendosje është bërë fakti se në Komisariatin e Kukësit nuk ka kapacitet për kaç persona të ndaluar, ndaj



Protestues para Drejtorisë së Policisë

EMRAT E PROTESTUESVE TË NDALUAR:

- Rasim Koloshi, 23 vjeç, banues në Kukës.
- Rasim Onuzi, 38 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
- Florin Onuzi, 35 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
- Shaban Selmani, 60 vjeç, banues në Kukës.
- Zenel Matmuja, 48 vjeç, banues në Kukës.
- Adem Duraku, 59 vjeç, banues në fshatin Morinë, Kukës.
- Xhevahir Gashi, 33 vjeç, banues në fshatin Nangë, Kukës.
- Armand Ademaj, 28 vjeç, banues në Kukës.
- Edmond Matmuja, 21 vjeç, banues në fshatin Pobreg, Kukës.
- Elton Cengu, 39 vjeç, banues në Kukës.
- Lefter Rexhmati, 38 vjeç, banues në fshatin Bushat, Kukës.
- Shpëtim Toda, 44 vjeç, banues në Kolsh, Kukës.
- Xhevahir Hereni, 51 vjeç, banues në Kukës.
- Shemsit Trota, 54 vjeç, banues në Shtiqen, Kukës.
- Vasil Laçi, 31 vjeç, banues në Kukës.
- Lulëzim Uka, 33 vjeç, banues në Kukës.
- Ervis Oruçi, 25 vjeç, banues në Kukës.
- Ardit Alidini, 21 vjeç, banues në Kukës.
- Fatos Harulla, 33 vjeç, banues në Kukës.
- Samjir Trota, 33 vjeç, banues në Kukës.
- Lulzim Popa, 60 vjeç, banues në Kukës.
- Shkëlqim Vata, 42 vjeç, banues në Surroj, Kukës.
- Abdi Haziraj, 49 vjeç, banues në Kukës.

PERSONAT NË KËRKIM:

- Isa Koloshi
- Bilbil Hila
- Xhetan Maja
- Avdi Duraku
- Arben Onuzi
- Dogjan Lleshi
- Fatjon Allamani
- Bilbil Hilaj
- Mirdian Nerguti
- Ahmet Tobli
- Pavlo Hoxha
- Shkëlqim Toda
- Avdi Gjahu
- Lufti Meçka
- Azgan Haklaj
- Idriz Nerguti
- Rexh Mici
- Ergis Koloshi
- Saimir Trota
- Lulzim Pola

strukturat policore morën këtë vendim. Të arrestuarit arrestuar nuk ndodhen të gjithë në ambientet e Drejtorisë së Policisë, por janë ndarë në disa komisariate. Mësohet se 12 protestues ndodhen në ambientet e paraburgimit në Drejtorinë e Policisë së Tiranës, 4 në Ko-

misariatin nr. 3 dhe 3 në Komisariatin nr. 1, ndërsa 4 të tjerë në Komisariatin nr. 2. Në njoftimin e saj, policia bëri të ditur se 23 personat u ndaluan për veprat penale "Shkatërrim i pronës me zjarr" nr. 2. Në kundërshtim i punonjësit të rendit publik".



Studiuësja dhe pedagoga amerikane Lory Amy është ndaluar gjatë ditës së djeshme nga policia e Tiranës në zonën e "Myslym Shyrit". Amy u ka kërkuar punonjësve të policisë që të mos lejojnë kalimin e automjeteve në një kohë ku familjarët e të arrestuarve në protestën e Kukësit janë mbledhur për të kërkuar lirinë e tyre para Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Studiuësja ka vërejtur që në rrugën e bllokuar nga njerëzit, policia lejonte hyrjen e makinave deri në një pikë të caktuar dhe më pas i detyronte ato të ktheheshin pas, duke krijuar një rreth të mbyllur lëvizjeje, që krijonte kaos në trafik. Zonja Amy është afruar tek policët duke u kërkuar që t'i orientojnë makinat që në hyrje të rrugës e të mos i lejojnë të hyjnë në zonën e protestës, por ata kanë refuzuar.

Lory Amy kërkoi moslejimin e automjeteve pranë tubuesve

Ndalohet nga policia studiuësja e njohur amerikane, tentoi të ndihmonte protestuesit



Studiuësja dhe pedagoga amerikane, Lory Amy në polici

NDALIMI
Amy u ka kërkuar punonjësve të policisë që të mos lejojnë kalimin e automjeteve në një kohë ku familjarët e të arrestuarve në protestën e Kukësit janë mbledhur për të kërkuar lirinë e tyre para Drejtorisë së Policisë së Tiranës. Policia i ka kërkuar të largohet, por pasi ajo ka refuzuar, kanë vendosur ta shoqërojnë në komisarjat.

Atëherë zonja ka dalë në rrugë dhe ka menduar të kryejë një detyrë qytetare, duke u thënë shoferëve ta shmangin zonën, sepse është e bllokuar. "Dukej sikur policisë i interesonte ky kaos", ka thënë zonja Amy.

Ata janë afruar dhe i kanë kërkuar të largohet, por pasi ajo ka refuzuar, policët kanë vendosur ta shoqërojnë në komisarjat. Profesoresha Amy është shoqëruar në komisarjatin nr. 3 të policisë nga të paktën 4 oficerë pol-

icie, ndërsa është pyetur për arsyet se pse ishte në protestë. Zonja Amy, e cila është pedagoge në Universitetin Jugor të Xhorxhias, ndodhet në Tiranë për studimin e saj lidhur me krimet e komunizmit.

"Kundërshtoj tarifën në Rrugën e Kombit, rroga mesatare e shqiptarëve është 250 mijë lekë në muaj"

Mori pjesë në protestë, procedohet penalisht avokati

Adriatik Lapaj: Po ushtrohet presion ndaj fjalës së lirë, shkelësit s'jemi ne

Ina Allkanjari

Protesta për taksën e Rrugës së Kombit u zhvendos dy ditë më parë në kryeqytet, kjo pas transferimit të 23 të arrestuarve në Drejtorinë e Policisë së Tiranës. Me pretendimin se kanë tubuar në mënyrë të paligjshme, ditën e djeshme ka nisur procedimi penal në gjendje të lirë për 8 qytetarë të tjerë, të cilët ishin pjesëmarrës në protestën e organizuar në kryeqytet. Një ndër personat e proceduar është avokati Adriatik Lapaj. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", avokati shprehet i revoltuar pasi sipas tij, në këtë protestë janë shkelur të drejtat e njeriut. "Konform të drejtave të mia kushtetuese, siç është liria për t'u shprehur, liria për të tubuar, kam mbajtur fjalën time në protestë, këtë të drejtë për çfarëdo lloj kostoje nuk do na e heqin dot", tregon Adriatik Lapaj.



Avokati Adriatik Lapaj

tencën e problematikës, pra që janë arrestuar banorët të Kukësit, sepse kanë kundërshtuar taksën e Rrugës së Kombit. Jam bashkuar si qytetar përpara Drejtorisë së Policisë në Tiranë, bashkë me familjarët dhe të afërm të shumtë të personave të arrestuar.
Çfarë ndodhi gjatë protestës dhe përse nisi procedimi ndaj jush?
Aty, konform të drejtave të mia kushtetuese, siç është liria për t'u shprehur, liria për të tubuar, kam mbajtur fjalën time dhe kam shprehur qëndrimin tim. Problemi është që kur njerëzit duan të flasin u thonë pse flisni, kur njerëzit fillojnë dhe nxehen dhe marrin gurët e theyjnë, i thonë pse thyeni, duhet të flisni që t'ju dëgjojmë. Në këtë rast unë fola si qytetar,

as theva, as dogja asnjë gjë. Këta mendojnë se duhet të na heqin edhe të drejtën e fjalës, por këtë të drejtë për çfarëdo lloj kostoje nuk do na e heqin dot, kjo është e sigurt.
Keni protestuar herë tjetër, apo ishte hera e parë?
Unë nuk kam asnjë problem, le të më procedojnë, është hera e dytë që e bëjnë brenda muajit për një rast të ngjashëm, ku unë kam mbajtur dhe kam thënë qëndrimin tim si qytetar në një protestë tjetër.
Cili është reagimi juaj në lidhje me rastin e fundit dhe a mendoni se keni shkelur ligjin?
Unë e konsideroj mjet të hapur presioni ndaj fjalës së lirë. Për sa kohë një qytetar nuk thyen, nuk djeg dhe nuk bën asnjë veprim që cenon rendin apo sigurinë



publike, këto kthehen në mjete diktatoriale për të kufizuar lirinë e shprehjes, të cilat unë i refuzoj me të gjithë fuqinë time edhe nuk i nënshtrohem, nuk i pranoj. Unë pranoj Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, që më jep të drejtën për të folur dhe për të thënë lirisht mendimin tim. Ata që thonë nuk do e shprehësh lirisht mendimin tënd, janë shkelës të plotë të Kushtetutës. Ata mund ta përdorin edhe policinë, edhe prokurorinë, por kjo nuk u jep të drejtë, nuk do të thotë që kanë të drejtë.
Sipas jush, kush janë dhunuesit apo shkelësit e ligjit?
Formë dhune është edhe kjo që po më ndodh mua dhe kolegëve të mi, pra të më imponosh që mos të them atë që mendoj. Nëse dhunë

dhe për të arrestuar ose dënuar.
Ju personalisht jeni pro apo kundër taksës në Rrugën e Kombit, apo thjesht u solidarizuat me banorët e varfër të zonës së Kukësit?
Jam bërë pjesë e protestës sepse besoj që qytetarëve shqiptarë po i bëhet një padrejtës. Çdo veprim i cili kryhet nën arrogancën e përdorimit të dhunës është i palegjitimuar për mendimin tim. Qeveria është zgjedhur për të marrë masa, për të marr vendime, por para se të marr vendimet, duhet të dëgjoj grupet e interesit, duhet të konsultohet, duhet të përcaktoj ekspertë vendës që njohin realitetin për të përcaktuar vlerat dhe duhet t'u japë shpjegime qytetarëve dhe kryesorja t'i bindë përse vendoset një shumë e tillë. Për sa kohë të gjitha këto nuk bëhen dhe u thuhet qytetarëve që në vazhdimësi do paguani këtë shumë, kjo nuk është normale, është joligjore dhe duhet të përballim me refuzimet e qytetarëve. Unë jam kundra asaj tarife, sepse banorët e Shqipërisë e kanë rrogën mesatare 250 mijë lekë të vjetra në muaj dhe nuk mund të paguajnë 250 mijë lekë kalim rrugë në muaj. Po shkelet e drejta e njeriut dhe ndjekja penalisht e 8 aktivistëve sot është edhe më e rëndë se vendimi i marrë.

AKSIONI OPOZITAR PROTESTAT

Kryetarja e LSI, apel shqiptarëve: Filloni mosbindjen civile, i thoni 'ik' Ramës

Protesta, Kryemadhi thirrje Kuvendit: Përrjashtoni Edi Ramën

"Të heqim dorën e kryeministrit nga xhepi i qytetarëve"

Valentina Madani

LSI do t'i kërkojë Kuvendit përjashtimin e kryeministrit Edi Rama nga parlamenti, duke e cilësuar qëndrimin e tij ndaj protestuesve për taksën në Rrugën e Kombit si antikombëtare. Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi mbledhi dje grupin parlamentar, pas së cilit deklaroi se partia e saj është në krah të qytetarëve, që sipas saj, protestojnë kundër zhvatjes që po u bën qeveria. Kryemadhi teksa dënoi gjuhën e përdorur nga kryeministri ndaj kosovarëve, njoftoi se do të kërkojë nga Kuvendi përjashtimin e tij. Kryemadhi akuzoi se Edi Rama dhe oborri i tij arrogant, të mbyllur në kullat e oligarkëve nuk e kuptojnë që sot shqiptarët janë ngritur kundër një regjimi skllavërues, që me krimin dhe bandat që i sollën në pushtet po i rrëmbejnë dhe dinjitetin shqiptarëve. Sipas Kryemadhit, fjala e tij përpara shqiptarëve ishte një fyerje që u bëhet jo vetëm banorëve të varfër të Kukësit dhe zonave përreth, por edhe një shprehje e qartë e antikombëtarizmit që i trajton kosovarët si klientë të pazareve të oligarkëve të tij. "Në zbatim të rregullores së Kuvendit, ne do të kërkojmë përjashtimin e kryeministrit nga parlamenti për këto shfaqje të shëmtuara dhe të paprecedenta për një kryetar qeverie. Qëndrimi ynë ndaj parlamentit do të jetë vendimmarrje politike në funksion të mënyrës se si kryeministri do të sillt ndaj kërkesave të qytetarëve të Kukësit dhe zonave përreth, që kërkojnë të drejtën e tyre. I bëjmë thirrje policisë dhe prokurorisë të jenë të kujdesshme me veprimet e tyre", theksoi kryetarja e LSI, Zj. Kryemadhi ftoi prokurorinë të zbatojë me korrektesë ligjin dhe të hetojë me paanësi dhe e pandikuar nga presioni i kryeministrit ngjarjen dhe të mos marrë në mbrojtje provokatorët dhe iniciatorët e dhunës të dërguar nga Edi Rama, por të hetojë edhe kontratën dhe të gjithë procesin e lidhjes së kontratës së koncesionit. "Çdo keqpërdorim politik do



Kryetarja e LSI,
Monika Kryemadhi

KËRKESA

"Në zbatim të rregullores së Kuvendit, ne do të kërkojmë përjashtimin e kryeministrit nga parlamenti për këto shfaqje të shëmtuara dhe të paprecedenta për një kryetar qeverie. Qëndrimi ynë ndaj parlamentit do të jetë vendimmarrje politike në funksion të mënyrës se si kryeministri do të sillt ndaj kërkesave të qytetarëve", tha Kryemadhi.

"Arrestimet kryhen deri në orën 22 të mbrëmjes"

Alibeaj: Me urdhër të Ramës, policia rrëmbeu 23 qytetarë kuksianë

Deputeti demokrat, Enkelejd Alibeaj u shpreh dje se arrestimi që iu bë 23 qytetarëve kuksianë është bërë jashtë çdo norme ligjore. Alibeaj përmendi se arrestimet mund të kryhen deri në orën 22 të mbrëmjes dhe jo gjatë mesnatës, siç është vepruar nga Policia e Shtetit në rastin e protestuesve në Rrugën e Kombit. "Ka shkelje dramatike të ligjit dhe të mënyrës së trajtimit të 23 qytetarëve. Janë arrestuar natën rreth orës katër. Sipas ligjit të procedurës penale, arrestimet mund të kryhen deri në orën 22 të mbrëmjes. Mësymja në orën 4 të mëngjesit duhet që të shoqërohet nga një shkresë nga ana e prokurorisë, gjë që nuk është e vërtetë. Sh-



kelja tjetër që ishte edhe më e rëndë, ishte fakti se vetëm dje në orën 2 pasdite janë lëshuar urdhër-arrestet. Ata janë rrëmbyer nga shëtitë e tyre, ata njerëz mbanen të sekuestruar, kundër çdo norme normale. Pyetja që shtrihet është se



SHKELJA

"Mësymja në orën 4 të mëngjesit duhet që të shoqërohet nga një shkresë nga ana e prokurorisë, gjë që nuk është e vërtetë. Shkelja tjetër që ishte edhe më e rëndë, ishte fakti se vetëm dje në orën 2 pasdite janë lëshuar urdhër-arrestet", tha Alibeaj.

pse gjithë ky ngut nga ana e prokurorisë dhe policisë?! Është thjeshtë dhe vetëm hakmarrja që Edi Rama po bën ndaj kuksianëve. Ky është dëmi më i madh që i shkaktohet publikut", u shpreh Alibeaj.

të ketë pasojë dhe nuk do të tolerohet nga ne. Ne po ndjekim minutë pas minute situatën. Opozita e bashkuar është në kontakt dhe bashkëpunim të vazhdueshëm për situatën e krijuar, duke pasur parësore gjendjen dhe trajtimin e të ndaluarve, që mbanen ende në qelitë e komisaritave që para se të nxi-tojnë t'i mbushin me qyteta-

rë të pajafshëm që protestojnë për të drejtën e tyre, duhet t'i kishin mbushur me trafikantët e drogës, kriminelët dhe bashkëpunëtorët e tyre me imunitet politik", theksoi ajo. Kryemadhi evidentoj se, "protesta është e drejtë e qytetarëve është një protestë, e cila duhet të vazhdojë dhe ne e përkrahim çdo protestë të tyre. Protesta

është e drejtë e qytetarëve shqiptarë për të kërkuar të drejtat e mohuara dhe askush nuk mund të cenojë këtë të drejtë. As ai që sot mendon dhe pretendon se i ka të gjitha pushtetet në duart e tij". Pas përfundimit të mbledhjes së opozitës së bashkuar, kryetarja e LSI-së, u bëri thirrje të gjithë qytetarëve shqiptarë që të



Kreu i PD-së, Lulzim Basha, dje në Shkodër gjatë ceremonisë përkujtimore të 2 prillit

Deputeti i PD, biznesmenëve: Jeni të hurit dhe të litarit, parazitë

Deputeti demokrat, Agron Shehaj, i cilësoi dje biznesmenët e mëdhenj në vend si të 'hurit e të litarit'. Referuar valës së protestave për taksën në Rrugën e Kombit, Shehaj deklaroi se biznesmenët duhet të ulin kokën. "Një komplot i kastës kundër popullit. U bënë të gjithë bashkë, me kuç e me maç, biznesmenët e mëdhenj u vunë sot në krah të gjyqtarëve, ministrave, politikanëve të korruptuar. Meskinët dhe servilet u bashkuan nën flamurin me sorrë të grabitjes kombëtare. Ky është kapitalizëm parazit dhe provincial. Nëpërmjet tij, biznesmenët e tenderave, lejeve të ndërimit, koncesioneve sulmojnë protestuesit. Pothuajse asnjë prej tyre nuk prodhon një produkt apo një shërbim në treg të lirë dhe transparent. Këta kapitalistë, të hurit e të litarit, në vend që të ulin kokën dhe të heshtin, bëhen me pushtetin kundër të varfërve. Dihet pse: pronat që mbrojnë tani janë ato që kanë vjedhur dje me korrupsion, forcë dhe servilizëm politik!", shprehet z. Shehaj.

Protesta, Salianji: Rama e ndau kombin për 10 euro

Deputeti i Partisë Demokratike, Ervin Salianji përmes një mesazhi në faqen e tij në "Facebook" 'sulmoi' kryeministrin Edi Rama, ndërsa kryefjala është taksa për Rrugën e Kombit. Demokrati theksoi se Rama ndau kombin për 10 euro, ndërsa pasi i zhvati, i futi në burg. Po ashtu, ai u bëri thirrje qytetarëve që t'i bashkohin protestës. "Edi Rama e ndau kombin për 10 euro! Rama, pasi i zhvat qytetarët, i dhunon dhe fut në burg! Protesta është shpirti i demokracisë, bashkohuni tek Drejtoria e Policisë, qytetarët e Kukësit protestuan për secilin nga ne, sot duhet t'i mbështesim!", shprehet deputeti i PD-së.

fillojnë mosbindjen ndaj kësaj qeverie. Kryemadhi tha se mosbindje qytetare do të thotë t'i thuasht 'stop' vjedhjes së Edi Ramës. Ndërsa shtoi se Rama ka instaluar në vend diktaturën. "Mosbindja qytetare do të thotë të heqim dorën e Edi Ramës nga xhepat e qytetarëve të varfër. Të heqim shqiptarët litarët që iu kanë hedhur në

qafë. Mosbindje do të thotë t'i thuasht 'ik' Edi Ramës dhe 'boll' ua more shpirtin shqiptarëve". U bëj thirrje gazetarëve t'i thoni 'jo' Edi Ramës. Rama po instalon diktaturën. Protesta qytetare ishte mësim edhe për opozitën. Gratë dhe nënat shqiptare i dhanë dinjitet çdo shqiptari", deklaroi Kryemadhi.



Valentina Madani

Nuk do të ketë bojkot të Kuvendit, por mosbindje civile që nis nga bllokimi i rrugëve, deri tek mospagesa e taksave. Opozita e bashkuar vendosi mbrëmë të jetë përkrah qytetarëve për mosbindje civile, duke nisur që sot me protestat në sallën e gjyqit të të arrestuarve në Rrugën e Kombit. Pas mbledhjes së përbashkët të grupeve parlamentare PD-LSI dhe krerët e degëve të dy partive, Lulzim Basha dhe Monika Kryemadhi njoftuan se brenda kësaj jave nis mosbindja civile dhe protesta masive në të gjithë vendin. Basha dhe Kryemadhi u kanë bërë thirrje qytetarëve të mos paguajnë asnjë taksë dhe të bashkohen në protestë, që sipas tyre, do të jetë me të gjitha format. Sipas kreut të PD, vendi qeveriset nga një bandë që grabit, vjedh, plaçkit shqiptarët, duke shtuar se këtë e tregoi qartë Kukësi. Lulzim Basha u bëri thirrje demokratëve për mosbindje civile, duke u kërkuar të bllokojnë rrugët, të mos paguajnë taksat e rritura, taksën e pronës, të Rrugës së Kombit, të ujit dhe dritave. "Hapësira e vetme për tu qëndruar në krah qytetarëve është mosbindja qytetare dhe kjo nis që këtë javë, në krah të qytetarëve me mosbindjen qytetare. Me refuzimin jo vetëm të takës së Rrugës së Kombit, por çdo takse tjetër që ka rritur Rama dhe me të gjitha hapat format dhe mënyrat e mosbindjes qytetare si forma më e lartë e veprimit politik dhe qytetar kundër një klিকে. Në këtë nuk do ta pranojmë, ndaj ky është një vendim unanimit opozitës, e cila nis që sonte organizimin për të bërë realitet mosbindjen qytetare, duke nisur nga mospagesa e taksave të rritura. Ne do të ndërthurim të gjitha format e nevojshme të aktivitetit opozitar, ashtu siç e gjykojmë të përshtatshme për të arritur qëllimin. Të gjitha format dhe mënyrat", theksoi z.Basha. Gjatë mbledhjes së përbashkët reagoi edhe ish-kreu i PD-së, Berisha. Teksa e cilësoi kryeministrin Rama "barbar të vërtetë", Berisha tha se protestat do të vijojnë deri në përmbysjen e kësaj qeverie dhe ato duhet të jenë të përditshme. "Ditë për ditë ku të na teket, ku të vendosim, ku të duam, t'i motivojmë njerëzit dhe të kemi një drejtim, një staf që do drejtojë mosbindjen civile gjër në përmbysjen e tij. Mirënjohje të thellë lumianëve që bënë një shkundje, një tërmet, në vetëdijen tonë për t'u ngritur gjër në ditën e fitores. Lëvizjet e mëdha fillojnë kur s'e pret. Ne kemi përballë një barbar të vërtetë që nuk ka lënë asgjë pa përdorur, në

Skenari për rrëzimin e qeverisë, nga bllokimi i rrugëve te mospagesa e taksave

Opozita e bashkuar, Basha: Mosbindje civile me çdo formë

Berisha: Protesta të përditshme sa herë të duam

VENDIMI

Kryesia e PD-së përjashtoi dje bojkotin e Kuvendit, teksa u vendos organizimi i protestave mbarëpopullore kundër qeverisë. Sipas opozitës, protestat do të thërriten kundër taksave, kundër grabitjes së shqiptarëve, kundër sundimit nga krimi. Sipas PD-së, zgjidhja nuk vjen vetëm nga kërkesat ekonomike, do të kërkohet edhe zgjidhje politike përmes një oferte të re për qytetarët.



Mbledhja e përbashkët PD-LSI

THIRRJA

"Vendimin duhet ta vëmë menjëherë në zbatim. Mos paguani taksat! Në këtë situatë ku Rama e ka futur vendin, ne nuk ndjekim interesin tonë vetjak, por duhet të jemi në krah të qytetarëve. Të vendosim cilat janë hapat e para, duke nisur me praninë masive të opozitës në sallën e gjyqit, sepse ata janë simboli i mosbindjes civile. Ne nuk çojmë kërkesë për leje në polici. Do ta kërkojmë kur të jetë Olsi Rama, Agron Xhafaj, Tahiri", tha z.Basha.

SPAHO



"Qeveria i preu në besë protestuesit"

Deputeti demokrat, Edmond Spaho thotë se është qeveria, ajo që shkeli marrëveshjen që kishte vendosur me protestuesit. Gjatë protestës para Drejtorisë së Policisë së Tiranës, Spaho tha se ishte rënë dakord që të pezullohej protesta në Rrugën e Kombit dhe të mos kishte arrestime. "Këtu nuk bëhet fjalë për rregulla dhe ligje, por ka pasur një akord me qeverinë dhe protestuesve që të pezullohej protesta në Rrugën e Kombit, të mos arrestoheshin njerëz, të hyjnë në dialog me autoritetet vendore për të gjetur një zgjidhje. Për fat të keq, qeveria e theu këtë marrëveshje në mirëbesim mes palëve dhe gjatë natës arrestoi 23 veta që ju tashmë e dini. Një përmbysje veprimeve të dhunshme me forca speciale, a thua se po kapnin kriminelët më të mëdhenjtë e këtij vendi që po bredhin të lirë. Qytetarët janë të vendosur që ata të lirohen", tha Spaho. Ai njoftoi se protesta do të vijojë deri në lirim dhe të arrestuarve dhe madje do të rritet, pasi do të ketë solidaritet edhe nga rrethet e tjera të vendit.

Ish-kryeministri Sali Berisha publikoi dje një video nga Kukësi. Ai shprehet se policë të armatosur deri në dhëmbë po terrorizojnë Kukësin, ndaj bën thirrje për revoltë. Qytetari që ka dërguar videon tek Berisha thotë se po trajtohen sikur i ka pushtuar serbi. "Banditë me uniformë, narkopolicë të armatosur deri në dhëmbë terrorizojnë Kukësin! Vetëm revolta, mosbindja mbarëpopullore ndaj narkoshitetit është përgjigjja e merituar ndaj klikës në pushtet! Z. Berisha, shiko se çfarë po ndodh në Kukës, po na trajtojnë sikur na ka pushtuar serbi me duket", thuhet në mesazh. Po dje ish-kryeministri Sali Berisha reagoi lidhur me zhvillimet e fundit që lidhen me protestën e qytetarëve për të kundërshtuar me çdo kusht taksën për Rrugën e Kombit. Përmes një statusi në faqen e tij të "Facebook"-ut, Berisha risolli në vëmendje raportin e

"Të arrestuarit s'janë ushqyer, s'ndodhte as në diktaturë"

Berisha: Policë të armatosur deri në dhëmbë, që terrorizojnë Kukësin



Avokatit të Popullit, ku ky i fundit ngrinte disa shqetësime lidhur me kushtet e 23 protestuesve të arrestuar dje gjatë natës. Berisha thekson se raporti vërteton se protestuesit janë rrëmbyer, pasi në kundërshtim me Kushtetutën, po mbahen sipas tij, të arrestuar pa do-

kumente, ndërsa shton se janë marrë peng. Dje Institucioni i Avokatit të Popullit reagoi për arrestimet e 23 protestuesve nga Kukësi, ndërkohë Erinda Balanca u shpreh se protestuesit e ndaluar nuk janë trajtuar me ushqim. Po ashtu, AP bën me dije se ka

PËRPARIM SPAHIU

"Jo 5 euro, por edhe 1 euro, kuksianët s'do të të lënë ta rivendosësh traun në atë vend. Pagesa ishte një hall i madh, pasi bëhet fjalë për verilindjen e këtij vendi, zonën që me qëllim e ke lënë më të varfrën, por më e rënda ishte se ti i kishe vënë tra vetëm Kukësin, ndarë si joshqiptarë. Un e di që ty s'ta ndjen të shkosh atje, por po e mendove ndonjëherë, mendoje mirë", tha dje deputeti i LSI-së.

radhë të parë kundër opozitës. Ndaj Kukësi e nisi, e ndezi shkëndijën. Ne nuk largohemi deri në përmbysjen e kësaj qeverie. A jemi shumë apo pak? Me siguri absolute ju them jemi shumë. Kjo është mosbindje me vendosmërinë që ta nisim dhe nuk kthehemi më", tha

z.Berisha. Mbledhjes i janë bashkuar edhe krerët e degëve të PD dhe LSI. Më herët kreu i PD-së paralajmëroi nga Shkodra kryeministrin Rama se ajo që nisi në Kukës, nuk do të ndalet deri në rrëzimin e qeverisë. "Ky është muaji kur maska e Edi Ramës ka rënë para çdo shqiptari,

taksa e Rrugës së Kombit, TVSH-ja për bizneset e vogla, taksa e rritur e banesave, faturat e rritura të ujit dhe të dritave, përjashtimi i mijëra familjeve nga ndihma ekonomike janë aktet e fundit të një grabitqari dhe mashtruesi që pasi e vjedh, e përbuz dhe tallet me popullin e

tij. Por unë i them sot nga Shkodra se i ka bërë hesapet gabim. I them sot nga Shkodra se ajo që nisi në Kukës, nuk do të ndalet dhe nuk ka për të ndaluar derisa tirania e krimit të rrëzohet", tha Basha, duke folur në ceremoninë përkujtimore të 4 heronjve të 2 Prillit në Shkodër.

TAKSA BIZNESI

Biznesi shqiptar solidarizohet me koncesionarin e Rrugës së Kukësit, dënojnë aktet vandale

Rruga e Kombit, Dhomat e Tregtisë: Tarifa, sipas standardeve ndërkombëtare

Jaka: Në Shqipëri nuk ka oligarkë, por sipërmarrës

Ornela Manjani

Biznesi shqiptar solidarisohet me koncesionarin e Rrugës së Kombit duke dalë kundër dhunës së ushtruar në protestën e së shtunës. Kreu i Dhomës së Tregtisë, Nikolin Jaka u shpreh se në Shqipëri nuk ka oligarkë, por sipërmarrës që kanë punuar paravarsisht klasës politike. Sipas tij protesta ishte prezantimi më negativ i Shqipërisë, i cili do të ndikojë te investimet e huaja. Gjatë fjalës së tij, kreu i Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Nikolin Jaka theksoi se dënojnë çdo akt dhune ndaj sipërmarrjes. "Do kërkojmë një dialog më të drejtë. Sot jemi në këtë reagim, jo në kushtet e negociimit të kontratës. Sot ne si forum dënojmë çdo akt vandali që ka shkatërruar një pasuri private. Secili prej nesh i bie ta braktisë këtë vend. Ne duhet të krijojmë optimizmin. Nëse do dalim të kundërshtojmë pa bërë analizë, atëherë eja e bëjmë. Por duhet të analizojmë. Rruga e Kombit është një procedurë 10 vjeçare e dështuar. Duhet të bëjmë analizat e sipërmarrësit investues. E dënojmë rëndë vandalizmin dhe mbështesim qytetarët. Por duhet të jemi së pari, qytetarë, tha Jaka. Ndërkohë, kreu i "Biznes Albania", Luan Bregasi theksoi se shqiptarët nuk janë mësuar që të paguajnë taksë për rrugën. "Jemi vend që nuk jemi mësuar të paguajmë taksën e rrugës. Ende nuk e dimë nëse është e ulët apo lartë, për shkak edhe të traditës së vendit. Në gjykimin e parë duhet të kishit më transparencë. Rruga e Kombit është arterie kryesore", tha Bregasi.



Përfaqësuesit Dhomave të Tregtisë

DEKLARATAT



NIKOLIN JAKA

Mendoj që ka ardhur momenti që ne të heqim dorë nga sloganet që nuk u shërbejnë as ndërmarjes dhe as qytetarëve. Sot nuk ka oligarkë, por janë sipërmarrës që kanë qenë edhe në kohën e një klase politike dhe në kohën e një klase politike tjetër.



FARRUK KABA

Nuk është e vërtetë se nuk ka rrugë alternative. Nga kthesa e 'Shën Mërisë', që vjen nga Morina janë 40 km. Atje mund të kalohet tek rruga e vjetër e deri në Rreps mund të përdoret përsëri kjo autostradë.



DEKLARATAT

"Mendoj që ka ardhur momenti që ne të heqim dorë nga sloganet që nuk i shërbejnë as ndërmarjes dhe as qytetarëve. Sot nuk



LUAN BREGASI

Jemi vend që nuk jemi mësuar të paguajmë taksën e rrugës. Ende nuk e dimë nëse është e ulët apo lartë, për shkak edhe të traditës së vendit. Në gjykimin e parë duhet të kishit më transparencë. Rruga e Kombit është arterie kryesore.

ka oligarkë, por janë sipërmarrës që kanë qenë edhe në kohën e një klase politike dhe në kohën e një klase politike tjetër", tha Jaka. Asnjëri prej nesh nuk i vjen mirë të trajtohet si oligark. Asnjë sipërmarrës nuk është oligark, por është një sipërmarrës që ka një kontratë, është një sipërmarrës që investon në Shqipëri. Nëse neve kalojmë në sloganet që nuk i shërbejnë stabilitetit dhe qëndrueshmërisë, nuk i shërbejnë investimit, ekonomisë, atëherë çfarë sinjali? Ku është sinjali që transmetohet sot tek qytetari, tek investitorët e huaj? Në lidhje me ndikimin që do të ketë vendosja e tarifës në tregtinë me Kosovën kreu i Dhomës së Tregtisë u shpreh se janë në diskutime me koncesionarin për të ulur tarifën për ata që e frekuentojnë më shpesh këtë rrugë. "Kur kemi një frekuencë të shpeshtë të kompanive, të cilat kanë produktin e qarkullimit tregtar të tyre, do të jetë favorizim dhe ulje

e ndjeshme e pagesës së taksës", tha Jaka. Ines Mucostepa u shpreh se dëmi nga protesta është rreth 7 mln euro ndërkohe që investimi i bërë deri më tani arrin në 15 mln euro në total. "Dënojmë rëndë çdo akt vandali dhe të paligjshëm ndaj sipërmarrjes private shqiptare". Ines Mucostepa. Farruk Kaba njohës i mirë i infrastrukturës në vend tha se për banorët e Kukësit ka alternative për të kaluar dhe koncesioni është i domosdoshëm në një kohë që mirëmbajtja llogaritet të arrijë deri në 260 mln euro. "Nuk është e vërtetë se nuk ka rrugë alternative. Nga kthesa e 'Shën Mërisë', që vjen nga Morina janë 40 km. Atje mund të kalohet tek rruga e vjetër e deri në Rreps mund të përdoret përsëri kjo autostradë", Farruk Kaba. Pagesa e kalimit në Rrugën e Kombit nisi disa ditë më parë, ndërkohe që tarifa për këtë rrugë u vendos pasi buxheti i shtetit e ka të pamundur që të sigurojë mirëmbajtjen e autostradës.

SHPALLJE (PËR SHITJEN E SENDIT TË PALUAJTSHËM NË ANKAND)

ME DATE 13.04.2018 NGA ORA 8:00 – 16:00, PRANË KESAJ ZYRE PËRMËBËRIMORE DO TË ZHVILLOHET ANKANDI PËR SHITJEN E APARTAMENTIT ME SIFERFAQE 80.25 m², NR. PASURIE 46/205ND+136, ZK 8518, VOL 43 I VENDOSUR NE DURRES L. 13 PLAZH, NE PRONESI TE SHOQERISE SIAC SH.P.K. CMIMI FILLESTAR PER CELJEN E ANKANDIT TË LËNË ESHTË 3.389.760 LËKË.

Te interesurit te paraqiten prane zyres permbareme A.D.R., Permbareus Gjyqesor Dorian Zazani, ne adresen : Durres, L.nr 2, rr. A.Goga, ose te kontaktojne ne nr. tel: 0672586883



Protesta në Rrugën e Kombit, reagon Konfindustria

Buxhuku: Menaxhim i përbashkët Shqipëri-Kosovë

Konfindustria vlerëson, se një strategji e re e mirëmbajtjes dhe përmirësimit të Rrugës së Kombit domosdoshmërisht duhet të diskutohet dhe vendoset bashkërisht sa me shpejt nga qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës. Në një njoftim për shtyp Administratori i Përgjithshëm Gjergj Buxhuku bën ditë ditur se Konfindustria vlerëson, se vetëm vendimi i përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për mënyrën e menaxhimit të Rrugës së Kombit, krijon kushtet bazë për uljen e kostove të mirëmbajtjes, kryerjen e investimeve të munguara, rritjen e efektivitetit ekonomik të shfrytëzimit të saj, duke prodhuar mirëqenie të prekshme për gjithë shqiptarët. "Një strategji e re e mirëmbajtjes dhe përmirësimit të Rrugës së Kombit domosdoshmërisht duhet të diskutohet dhe vendoset bashkërisht sa me shpejt nga qeveritë e Shqipërisë dhe Kosovës. Rruga e Kombit, përfshi edhe pjesën e Kosovës, është me vlera jetike të shumëfishta për shqiptarët. Rruga është ndërtuar me kosto mbi 2 miliardë euro nga shqiptarët e dy anëve të kufirit dhe duhet të menaxhohet si një pasuri e vetme nga Tirana, Durrësi deri në Prishtinë e me tej në korridorin europian. Zgjidhjet e njëanshme dhe që nuk parashikojnë të gjithë ndikimet ekonomike, politike, shoqërore në shkallë vendi dhe krahine, rrezikojnë të ulin ndjeshëm vlerën strategjike të investimit dhe të prodhojnë pasojë të rënda për biznesin dhe qytetarët, përfshi edhe ngjarje të papranueshme sikurse ato të Tunelit të Kalimashit"-thuhet në njoftimin e Konfindustrisë.



Shoqëria përmbareme "STRATI BAILIFF'S SERVICE" Sh.p.k. njofton shpalljen për shitjen në ankand të pasurive të paluajshme:

- "Pylif", me sipërfaqe 6000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/422 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 82, regjistruar në pronësi të Shoqëria "Gjyze-BLS" sh.a. lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2167 Rep. Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 15,120,000 Lëkë;
- "Pylif", me sipërfaqe 1000 m², ndodhur në Qerret, Kavajë, me Nr. 1/424 Pasurie, Zona Kadastrale 3101, volumni 21, faqe 81, regjistruar në pronësi të Ylli Braka dhe Emira Braka, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2167 Rep. Nr. 1405/2 Kol., datë 23.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 2,520,000 Lëkë;
- "Truall", me sipërfaqe 2497 m², nga e cila 2497 m² truall dhe 161 m² ndërtesë ndodhur në Metalurgji Elbasan, me Nr. 432/3 Pasurie, Zona Kadastrale 3965, volumni 4, faqe 247, regjistruar në pronësi të Armand Shuqzi, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 2173 Rep. Nr. 1409/2 Kol., datë 24.08.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 3,133,065.6 Lëkë;
- "Arë+Truall", me sipërfaqe 4,500 m², nga e cila 400 m² truall dhe 176 m² ndërtesë, ndodhur në Sallmonë, Durrës, me Nr. 1781/1 Pasurie, Zona Kadastrale 3255, volumni 6, faqe 135, regjistruar në pronësi të Bajram Cjuzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore Nr. 657 Rep. Nr. 311/1 Kol., datë 11.08.2014 dhe Kontratë Hipotekore Nr. 1512 Rep. Nr. 1356/3 Kol., datë 23.10.2010. Çmimi fillestar i ankandit është 9,534,672 Lëkë;
- "Dygan", me sipërfaqe 60 m², ndodhur në Rruga e Durrësit, Tiranë, Zona Kadastrale 8310, regjistruar në pronësi të Bajram Cjuzeli, lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 11.04.2018.

Ankand për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbareme "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

Thellimi i marrëdhënieve mes dy vendeve ishte në fokus të takimit që zhvilloi ministri i Shtetit për Diasporën me Grupin Parlamentar të Miqësisë Shqipëri-Turqi. Gjatë bisedës së zhvilluar në ambientet e parlamentit turk, u diskutua për mundësinë e takimeve të rregullta midis Grupeve Parlamentare të Miqësisë, për të forcuar edhe më tej lidhjet mes Turqisë dhe Shqipërisë. Parlamentarët turq shprehën interesin për bashkëpunim në fusha të ndryshme, veçanërisht atë të diasporës. U fol gjithashtu për rëndësinë e shkëmbimit të eksperiencave, në kuadër të projekteve të përbashkëta. Ministri Majko informoi për

Ministri i Shtetit për Diasporën, takime me parlamentarët turq

Majko në Turqi, bashkëpunim për problematikat e diasporës

E DREJTA E VOTËS

Në takimet e ministrit në Turqi u fol gjithashtu për përpjekjet që po bëhen për t'u garantuar emigrantëve të drejtën e votës, me zyrtarin turk që informoi ministrin lidhur me eksperiencën e Turqisë. Autoritetet turke, sipas tij, janë të gatshme të ndihmojnë Shqipërinë për të kthyer në realitet këtë ambicie.

faqësuesit e Grupit Parlamentar të Miqësisë për progresin e shënuar deri më tani, në përpjekje për ndërtimin e strukturave mbështetëse për shqiptarët e diasporës. Ndërkaq, në

takimin e zhvilluar në Institutin e Diasporës në Ankara, ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko, mori garancinë për përkrahimin e veçantë të autoriteteve turke lidhur me

diasporën shqiptare atje. Drejtori i këtij instituti, z. Mehmet Köse, u shpreh i nderuar nga vizita e z. Majko në Turqi dhe theksoi nevojën e bashkëpunimit me autoritetet shqiptare për problematika të diasporës. "Bashkëpunimi në këtë fushë është jetësor, veçanërisht për një komunitet të madh e të rëndësishëm si ai shqiptar në Turqi", u shpreh drejtori i institutit që ofron bursa të niveleve të ndryshme për studentët shqiptarë. "Po humbe gjuhën,



Ministri i Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko me drejtorin Mehmet Köse

ke humbur një pjesë të identitetit dhe për këtë arsye, ne kemi mbledhur specialistë të fushave të ndryshme në këtë institut", vijoi zyrtari turk. Ai tha se po punohet për krijimin e infrastrukturës së nevojshme që do të ndihmojë në krijimin e një sistemi dygjuhësor. Ministri nga ana e tij shprehu falën-


derimet për mbështetjen që Turqia u ka ofruar emigrantëve shqiptarë. Ai informoi të pranishmit mbi progresin e shënuar sa u përket përpjekjeve për të institucionalizuar marrëdhëniet e shtetit shqiptar me diasporën. Z. Majko e vuri theksin tek rëndësia e bashkëpunimit për projekte të përbashkëta.

9 deputetët që u tërhoqën nga nisma për 26 shkurtin si "Dita e Kujtesës"

Viktimat e komunizmit, zbardhet shkresa e PD-së për Gramoz Ruçin


Në fuqi mbetet 20 shkurti, rrëzimi i bustit të diktatorit

Një grup prej nëntë deputetësh të Partisë Demokratike kanë depozituar që në mars një kërkesë për ndryshimin e ligjit për festat zyrtare. Në kërkesën e tyre, e cila zbardhet sot nga "Gazeta Shqiptare", ata kërkonin që data 26 shkurt të shpallej ditë përkujtimore "Dita e Kujtesës së Viktimave të Regjimit Komunist". 9 deputetët demokratë: Jorida Tabaku, Agron Shehaj, Edmond Spaho, Flamur Noka, Ervin Salianji, Grida Duma, Bardh Spahia, Edi Paloka dhe Genc Pollo kërkuar të bëjnë një shtesë në projektligjin "Për festat zyrtare e ditët përkujtimore", të ndryshuar Në relacionin që shoqëronte kërkesën e tyre, thuhej se regjimi komunist në Shqipëri shkaktoi mijëra viktima të pafajshme. "Shqipëria u shndërrua në një burg të madh. Të dhënat paraprake mbi burgimet, pushkatimet dhe internimet, të nxjerra nga arkiva e Institutit Shtetëror të Integritetit të të Përndjekur Politikë, tregojnë se: 1. Të ekzekutuar janë 6.023 vetë; 2. Të vdekur në burg 1.065 vetë; 3. Të burgosur 17.300 vetë; 4. Të sëmurrë mendorë të motiuvar politikisht 900 vetë; 5. Të internuar 180.000 vetë; 6. Të vdekur në internim 9.000 vetë. Po t'u shtojmë këtyre shifrave edhe numrin e fëmijëve të internuar nën 14 vjeç, që nuk janë regjistruar dhe përfshirë në këto lista në kampet e internimeve, atëherë rezultojnë se numri i përgjithshëm i atyre që kanë pësuar drejtpërdrejt persekutimin arrin mbi 300.000. Duke marrë parasysh se gati 70% e tyre i përkasin periudhës deri në vitin 1954, kur popullsia e vendit ishte afërsisht 1.000.000 njerëz, rezultojnë se 1/3 e asaj popullsie është dënuar e persekutuar direkt në burgje e kampe internimi", thuhet në relacion. Më tej, nëntë deputetët e djathtë thonë se rënia e regjimit komunist nuk u pasua me një hetim dhe ndëshkim ligjor të krimeve dhe të kriminelëve e se



persekutorët nuk u përballën me drejtësinë, nuk u kërkuar falje viktimave të gjenocidit komunist. Ata japin 9 arsye se përse duhet fiksuar data 26 shkurt si dita përkujtimore e viktimave të komunizmit. "Rrëdhimisht edhe njohja dhe denoncimi i krimeve të komunizmit, ndërgjegjësimi i opinionit publik shqiptar, sidomos i brezit të ri për atë tragedi kombëtare me pasojë të rënda, ishte dhe është fare i dobët, ndërkohë që propaganda komuniste që ende vazhdon në politikë, mediat, botimet, tekste shkollore,

filmat e periudhës së socializmit etj., bën punën e vet për motivimin e krimeve, madje edhe mitizimin e bëmave të komunizmit. Ndërkohë, shteti demokratik nuk e ka kryer rolin e tij në këtë drejtim", thuhet më tej. Deputetët e djathtë thonë se është shumë e dobishme edhe kujtesa duke propozuar edhe ngritjen e memorialëve, ngritjen e obeliskut të viktimave dhe të krimeve të komunizmit", kthimin në muze të burgjeve dhe kampeve të përgendrimit, si burgu i Spacit apo të kampit të internimit të Tepelenës.



Ministri i Jashtëm merr pjesë në ekspozitën me foto të vjetra shkodrane

Bushati: Politikanët të mbështesin nismat që promovojnë vlerat kulturore

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, Ditmir Bushati mori pjesë në ekspozitën "SHKODRA, familja-shtëpia-historia ime", ku theksoi se "Detyrë e politikanëve është edhe mbështetja e iniciativave të tilla". Ekspozita ishte ndërtuar me foto të vjetra të shtëpive shkodrane para viteve '90, të cilat përtej të qenit godinë, shpalosin historinë. Aktiviteti u zhvillua në shtëpinë e Ismet Halilit, Monument Kulturë i Kategorisë I dhe u shpalosën 50 foto të



Shkodrës dhe Prizrenit. Ministri Bushati vlerësoi këtë nismë në promovimin e vlerave dhe theksoi se është detyra

- DEPUTETËT QË U TËRHOQËN**
- JORIDA TABAKU
 - AGRON SHEHAJ
 - EDMOND SPAHO
 - FLAMUR NOKA
 - ERVIN SALIANJI
 - GRIDA DUMA
 - BARDH SPAHIA
 - EDI PALOKA
 - GENC POLLO

e politikanëve për të mbështetur iniciativat e tilla. Ministri Bushati bëri me dije se "sivjet është viti evropian i trashëgimisë dhe kjo që po shohim në këtu është vetëm një pjesë e trashëgimisë kulturore dhe kontributit që ka Shkodra. Jo thjesht në historinë e Shqipërisë, por të kombit shqiptar". Për ministrin Bushati përzgjedhja e Shkodrës dhe Prizrenit ka simbolikën e vet, jo vetëm nga pikëpamja arkitekturore, por edhe për simbolikën e bashkimit kombëtar.

Shitje me Ankanë të para nga Studio Perbarimore L.D.C

"Apartment" me nr. pasurie 1/1309+1-19, vol. 37, faqe 217, ZK. 8532, regjistruar në Zyren Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajshme Fier. Me çmim shitje 36.000 Euro

Data e shpalljes 15.03.2018
 Data e zhvillimit 11.04.2018 deri në orën 16.00
 Ankandit zhvillohet në ambientet e zyrës Studio Perbarimore L.D.C të ndodhur në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8/1, Kati 1, Tiranë, e-mail: erjon.papallazo@yahoo.com.

Autori në polici: S'e di çfarë ndodhi. Nëse shoku im ka vdekur, nuk e dua më jetën"

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Një 28-vjeçar nga Shkoda është vrarë me thikë në zemër nga shoku i tij. Dy të rinjtë, pasi kanë pirë për orë të tëra në një lokal, janë konfliktuar me njëri me tjetrin, ndërsa shërri ka degjeneruar deri në përdorimin e armës së ftohtë. Për pasojë, Kolë Fermosi është plagosur rëndë, ndërsa ka ndërruar jetë në spitalin rajonal të Shkodrës. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarqi bënë me dije se ngjarja e rëndë ndodhi në orët e para të mëngjesit të djeshëm në fshatin Hot i Ri. Pas sinjalizimit për ekzekutimin e 28-vjeçarit, blutë kanë shkuar menjëherë në vendngjarje dhe kanë vënë në pranga autorin e krimit, Kristian Shkambi. Gjatë marrjes në pyetje, ai ka deklaruar se nuk e di se çfarë e si ka ndodhur dhe se është shumë i tronditur.

VRASJA

Sipas burimeve policore, mbremjen e së dielës, Kolë Fermosi dhe 27-vjeçari Kristian Shkambi kanë qënë duke pirë së bashku në lokalin e fshatit. Mësohet se dy të rinjtë nuk kanë qënë të shoqëruar me persona të tjerë në tavolinë. Në mesnatë, ata kanë filluar të debatojnë dhe të shahen me njëri-tjetrin nën efektin e alkoolit, gjë e cila u ka bërë përshtypje klientëve të tjerë të lokalit, duke pasur parasysh faktin se ata ishin shokë. Rreth orës 00:30 të ditës së djeshme ata kanë dalë nga lokali dhe fillimisht janë ndarë me njëri-tjetrin

Vret shokun me thikë në zemër pas sherrit në lokal, kapet 27-vjeçari

Dy të rinjtë pinë alkool për orë të tëra



27-vjeçari i arrestuar, Kristian Shkambi

duke u nisur për në banesat e tyre, që ndodhen jo shumë larg vendit të ngjarjes. Burimet e mësipërme pohuan se 27-vjeçari Shkambi është larguar për në shtëpi, por në pak minuta është rikthyer dhe është takuar përsëri me shokun e tij, me të cilin kishte qëndruar për disa orë. Mes tyre ka vijuar debati

dhe pasi janë sharë me njëri-tjetrin, Kristian Shkambi ka nxjerrë një thikë që e mbante me vete dhe e ka goditur në zemër Kolë Fermosin, duke e lënë të plagosur rëndë. Menjëherë i riu është dërguar në spitalin e Shkodrës, por pavarësisht ndihmës së shpejtë të dhënë nga mjekët, ai nuk ka arritur që


PENDIMI
"Unë nuk e dua jetën nëse shoku im ka vdekur. As vetë nuk e di se si ka ndodhur dhe se çfarë ndodhi. Jam i tronditur nga ajo që ka ndodhur. Nuk kam dashur kurrë që ta vras shokun tim, por ishim të dy të pirë dhe debatuar me njëri-tjetrin. Nuk kam qënë në një gjendje normale dhe për shkak të gjendjes së dehur u ngatërruam bashkë. Shumë gjëra nuk i mbaj mend", është shprehur në polici 27-vjeçari Kristian Shkambi.

t'i bëjë ballë plagës së rëndë. Ndërkaq, policia ka mbërritur në vendngjarje dhe fillimisht ka bërë rrethimin e zonës dhe më pas ka kryer veprimet e para hetimore. Blutë janë vënë në ndjekje të autorit të krimit Kristian Shkambi. Mësohet se ai u arrestua pak minuta pas vrasjes tek disa të afërm të

tij (jo shumë larg nga vendi i ngjarjes). Në momentin që ka mbërritur policia, agresori nuk ka bërë asnjë lloj rezistence.


DËSHMIA E VRASËSIT

Pak orë pas ngjarjes, 27-vjeçari Kristian Shkambi, pasi është kthjelluar duke qënë se ndodhej nën efektin e alkoolit është penduar për çfarë ka bërë. Burime pranë policisë pohuan se Shkambi ka shfaqur pendesë për vrasjen e shokut të tij, Kolë Fermosi. "Unë nuk e dua jetën nëse shoku im ka vdekur. As vetë nuk e di se si ka ndodhur dhe se çfarë ndodhi. Jam i tronditur nga ajo që ka ndodhur. Nuk kam dashur kurrë që ta vras shokun tim, por ishim të dy të pirë dhe debatuar me njëri-tjetrin. Nuk kam qënë në një gjendje normale dhe për shkak të gjendjes së dehur u ngatërruam bashkë. Shumë gjëra nuk i mbaj mend. Tani që ka vdekur shoku im, unë nuk e dua jetën dhe jam tejet i penduar për çfarë kam bërë. Ende nuk më besohet dhe më vjen shumë keq. Nuk duhej të ndodhte kurrë", ka thënë Kristian Shkambi.



Gjendet varka e braktisur dhe letra me porosinë: Jam Landi, po mbytem!

VLORË - Një varkë e braktisur është gjetur dukë në plazhin e Zvërnecit në Vlorë, ndërsa ka dyshime të forta se personat që udhëtonin me të mund të jenë mbytur. Ndohëse ende nuk dihet kush janë peshkatarët, policia ka mundur të gjejë një letër që përforcon dyshimet. Në letërën e siguruar nga "Gazeta Shqiptare", një person që quhet Landi lajmëron se po mbytet bashkë me të tjerë, ndërsa i lë amanet nënës fëmijët dhe i tregon vendin ku ka fshehur kurset. "Unë jam Landi, po mbytem! Nuk kam më kohë. Nënë Jorgjia të kujdeset për fëmijët. Lekët i keni tek pllakat e fundit të banjës", - shkruhet në letër. Ndërkaq, policia e Vlorës ka nisur menjëherë kërkimet. Pak ditë më parë u shënuan një tjetër zhdukje e mistershme në Vlorë. Bëhet fjalë për 32-vjeçarin Santo Ymeraj, i cili kishte dalë në det me një motor uji dhe telefonin familjen e tij pak para se celulari i tij të fikje. Më pas ai nuk u bë më i gjallë. Pas pesë ditësh kërkimesh për të, policia e qytetit bregdetar u sinjalizua për zhdukjen misterioze të një personi tjetër, i cili kishte lënë një mesazh. Uniformat blu dyshojnë se dy ngjarjet mund të kenë lidhje me njëra-tjetrën.



Met Kanani


Policia shqiptare zbarkon në Stamboll për "Baronin e drogës", Met Kanani

TIRANË - Një grup i policisë shqiptare dhe prokurorë të Krimeve të Rënda kanë mbërritur në premtën në Stamboll për të marrë informacione në lidhje me "Escobarin shqiptar" të arrestuar. Bëhet fjalë për Met Kanani (i njohur ndryshe si "Met shqiptari"), të cilit iu sekuestrua pak ditë më parë një sasi prej 1.1 tonë kanabis. Ndërkohë, 11 të arrestuarit, përfshirë dhe Kanani kanë dalë para trupit gjyqës. Po ashtu, policia në Stamboll gjeti edhe një magazinë që përdorej nga shqiptari për të mbjellë kanabis. Ka dyshime të forta se ai e ka bërë disa herë këtë rrugë, ndërsa nëntorin e kaluar arriti t'i shpëtonte policisë greke në Egje. Gomonia u bllokua me 1.3 tonë kanabis, por Met Kanani nuk la asnjë gjurmë. Mësohet se prej më shumë se 6 muajsh autoritetet turke kanë zhvilluar hetime për Met Kanani. Ekipet e Drejtorisë së Antitrafikut në Stamboll kishin pikasur disa njerëz të Met Kanani të Turqi dhe kishin nisur ndjekjen e tyre. Në mes të muajit mars, me mbërritjen e Met Kanani në Bodrum, policia nisi ndjekjen e tij nga afër. Gjatë hetimeve u pa se Met Kanani po shikonte mbërritjen e drogës me një jaht në brigjet e Mulas, nga maja e një kodre. Por "Escobarin shqiptar" nuk e dinte se po ndiqej nga policia, e cila edhe e kishte fotografuar.

Kosovari e quante veten "bosi i kufirit"

Amerikanët mbërrijnë në Shqipëri, nisin hetimet për "trurin" e ISIS, Mirsad Kandiç

TIRANË - Autoritetet amerikane vijnë në Shqipëri për të hetuar. Bëhet fjalë për kosovarin Mirsad Kandiç. Gjykata për Krimet e Rënda i ka dhënë dritë jeshile një letërporsie të dërguar nga autoritetet amerikane të drejtësisë për llogari të një procedimi penal kundër një të dyshuari për "terrorizëm". Përmes saj, Departamenti i Drejtësisë në SHBA i kërkon palës shqiptare kryerjen e disa veprimeve hetimore në vendin tonë për çështjen penale të regjistruar në Nju Jork ndaj kosovarit Mirsad Kandiç. Ky i fundit dyshohet të ketë qënë anëtar i ISIS, të ketë propaganduar për Shtetin Islamik, si edhe të ketë ndihmuar në rekrutimin e mijëra personave. Kandiç u arrestua në Bosnjë, në tetor të 2017-ës, nga ku u ekstradua drejt SHBA. Mëso-



het se ai e quante veten "bosi i kufirit", midis Sirisë dhe Turqisë. Autoritetet amerikane e përkrahajnë atë si një nga ushtarët më të pamëshirshëm të Shtetit Islamik. Kandiç kishte 10 identitete të ndryshme dhe përpara arrestimit hyri në Bosnjë me një pasaportë nga Kosova, me emrin Ivan Popović. Kosovari Kandiç ka lindur në vitin 1981, në Pec dhe

ka jetuar në SHBA, ndërsa kishte dhe "Green Card". Ai është në listën e njerëzve të kërkuar nga Departamenti Amerikan i Drejtësisë që nga viti 2014, ndërsa një urdhër ndërkombëtar i kuq është lëshuar dy vjet më vonë. Sipas hetimeve, kosovari ka organizuar të paktën 20.000 kallime në territorin e kontrolluar nga Shteti Islamik. Zakonisht kanë qënë njerëz nga Evropa, por nuk mungonin rastet kur kalonte shqiptarë të Kosovës dhe të Shqipërisë. Po ashtu, SHBA pretendon se Kandiç ka kryer edhe detyra të tjera në operacionet e ISIS: nga mbulimi i terroristeve, kontrollimi i njerëzve që duhej të përfundonin sulmet në emër të ISIS dhe ndërtimi i pajisjeve për ato sulme. Dyshime të forta ka se "truri" i ISIS prej një kohe të gjatë është fshehur edhe në Shqipëri.

Transportonte klandestinë drejt Malit të Zi, pranga të riut nga Tirana

GJIROKASTËR - Goditet një tjetër rast i trafikut të klandestinëve, ndërsa ka përfunduar në pranga një 29-vjeçar. Policia Kufitare e Gjirokastrës në vijim të punës për parandalimin dhe goditjen e trafikimit të klandestinëve nga vendet e treta, të cilët hyjnë në territorin shqiptar në mënyrë të paligjshme nëpërmjet kufirit jeshil me Greqinë kanë arrestuar Rinor Thaçin, banues në Tiranë. 29-vjeçari akuzohet për veprimet penale: "Dhënie ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit kundrejt fitimit". Mësohet se i riu u kap në hyrje të qytetit të Tepelenës, duke transportuar me automjetin e tij në drejtim të Shkodrës me destinacion Malin e Zi dhe më pas një nga vendet e BE-së, 5 shtetas të huaj siri-anë. Materialet në ngarkim të tij do t'i kalojnë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për veprime të mëtejshme.

Bizneset e vogla me xhiro mbi 2 milionë hyjnë në skemën e Tatimit mbi Vlerën e Shtuar

Ornela Manjani

Drejtorja e Tatimeve shpjegon bizneset që hyjnë në skemën e TVSH-së në fillim të prillit për të gjitha proceduarat që duhen të ndjekin me dokumentacionin. Bëhet fjalë për rreth 11.500 biznese të vogla, të cilat realizojnë një qarkullim vjetor mbi 2 milionë lekë të vitit, të cilët duhet të fillojnë të mbajnë inventar, të marrin faturë tatimore për çdo blerje, që bëjnë nga shitësit me shumicë apo prodhuesit direkt, si dhe të fiskalizojnë kasën. Tatimet i bëjnë me dije bizneseve se duhet të bëjë kujdes me faturat për çdo mall që blejnë, të lëshojnë faturë për çdo mall që shesin, të lëshojnë kupon tatimor për çdo mall që shesin për konsumatorin final. Deklarimin e parë, bizneset që do përfshihen në TVSH, do të duhet ta bëjnë në korrik, pasi do të jetë çdo tre muaj. Duke filluar nga korriku i këtij viti, ata do të duhet të plotësojnë deklaratat e tyre të TVSH-së, do të duhet të plotësojnë librat e tyre të shitjes dhe blerjes. Është një proces jo shumë i ndërlikuar. Tashmë biznesi është familjarizuar me këtë mënyrë deklarimi, sepse listë-pagesat, gjithashtu, deklarohen një herë në tre

Tatimet për 11.500 biznese: Ja çfarë dokumentesh duhet të plotësojnë

Duhet të mbajnë inventar, të marrin faturë tatimore dhe të fiskalizojnë kasën



muaj siç do të deklarohet dhe tatimi mbi vlerën e shtuar. Ndërkohë bizneset e vogla e kanë kundërshtuar përfshirjen në skemën e TVSH-së, me pretendimin se do të ndikojë në rritjen e

kostove, të cilat më pas do reflektohen në çmimin fundor për konsumatorët. Në tre muajt e parë të vitit (nga 3 janari deri në 30 mars) kanë kaluar në status pasiv 3652 biznese, sipas listës së

përditësuar nga tatimet të subjekteve me status pasiv në vend. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka një rritje të ndjeshme me 45% të subjekteve të mbyllura. (Në tre muaj

NË TRE MUAJ

Gjatë periudhës nga 3 janari deri në 30 mars kanë kaluar në status pasiv 3652 biznese, sipas listës së përditësuar nga tatimet të subjekteve me status pasiv në vend. Në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka një rritje të ndjeshme me 45% të subjekteve të mbyllura. Ndërkohë, në tre muajt e parë të një viti më parë numri i subjekteve të mbyllura ishte 2523.



jt e parë të një viti më parë, numri i subjekteve të mbyllura ishte 2523). Ndërsa në krahasim me tre muajt e parë të 2016-n, numri i subjekteve është dyfishuar. Rritja e numrit të bizneseve të

mbyllura lidhet me pasojat e krizës dhe formatimit të ekonomisë drejt zinxhirëve të mëdhenj tregtarë, çka po godet subjektet e vogla, por edhe me uljen e pragut të TVSH-së nga 5 në 2 milionë lekë, efektiv që nga 1 prilli. Tatimet njoftuan pak kohë më parë se është konstatuar shtimi i numrit të aplikimeve pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, për çregjistrim apo pezullim të aktivitetit, nga tatimpagues që janë penalizuar për shkelje të ndryshme nga administrata tatimore, që kanë ndryshuar përgjegjësinë tatimore si dhe tatimpagues, të cilët, për herë të parë, hyjnë në skemën e TVSH-së dhe regjistrime të menjëhershme në po të njëjtën njësi nga persona të lidhur me tatimpaguesit që e zotëronin më parë këtë aktivitet.

Në mesin e 8 vendeve që pengon gratë në tregun e punës

BB: Shqipëria nuk i trajton njësoj meshkujt me femrat

Banka e Botërore vëren se në vitin 2018 Shqipëria bashkë me 7 vende të tjera të Europës aplikon të paktën një kufizim për punësimin e grave. Sipas të dhënave të tabelës së raportit, Shqipëria nuk ka kuota për gratë në bordet e korporatave, në Këshillat Bashkiake, për vendet në parlament, ndërsa ka një kuota prej 30% në listën e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare dhe këshillave bashkiakë (në shtetet e tjera kjo kuota varion përgjithësisht nga 40-50%). Shqipëria nuk ka incentiva (p.sh. financiare) për partitë politike që të përfshijë gratë në listën e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare, por as shumicave e vendeve nuk e kanë këtë, me pak përjashtime si p.sh. në rajonin e Kanës në Bosnjë, Kroacia. Banka ka gjetur se, boshllëqet gjinore krijojnë të ardhura të ulta. Huluntimet tregojnë se shkaktojnë 15% humbje të ardhurash në ekonomitë e zhvilluara. Këto humbje janë dukshëm më të larta në vendet në zhvillim. Përveç kësaj, dallimet gjinore ligjore vlerësohet se



pengojnë pjesëmarrjen e femrave në tregun e punës. Studimi vlerëson se për disa ekonomi pabarazia në të ardhurat për frymë i dedikohet pikërisht pabarazisë gjinore. Banka Botërore pohon se shumë vende mund të rrisin prodhimin për frymë duke dekurajuar barrierat gjinore në tregun e punës. Gjetjet e Bankës Botërore tregojnë se ligjet mund të ndikojnë barazinë ekonomike të grave. Në Shtetet e Bashkuara, për shembull, gratë filluan të marrin patentat në shekullin e 19-të. Mundësitë e barabarta i lejojnë gratë të bëjnë zgjedh-

jet që janë të mira për ta, familjet e tyre dhe komunitetet e tyre. Por mundësitë e barabarta në punë apo biznes nuk ekzistojnë ku dallimet ligjore gjinore janë mbizotëruese. Në shumë vende kufizimet ligjore kufizojnë gratë për të marrë vendime ekonomike. Ndërsa pjesëmarrja e grave në punësim dhe aktivitetet sipërmarrëse lidhet me shumë faktorë, të dhënat e Bankës Botërore për vitin 2018 tregojnë se si ligjet dhe rregulloret kufizojnë pjesëmarrjen e grave në të drejtat ekonomike. Banka merr shembull rastin e një vajze që synon të jetë kapiten i një anijeje. Ajo shkëlqen në shkollë për përbushjen e ëndrrës së saj. Rusia Svetlana Medvedeva, studioi navigimin në kolegji aplikoi për të punuar si drejtuese e një anijeje dhe u zgjodh. Më vonë ajo e humbi punën pasi Rregullorja nr 162 e rendit timonierin si një nga 456 punët e konsideruara si tepër të rënda, të dëmshme ose të rrezikshme për gratë. Medvedeva hodhi kompaninë në gjykatë, bazuar në të drejtat e barazisë që jepte Kushtetuta Ruse. Rasti i saj u hodh poshtë nga gjykata.



The European Union Delegation to Albania is looking for

Press and Information Officer

Functions include managing outreach activities; follow political developments; managing the EU Delegation website and social media platforms; liaise with EU desks in municipalities.

We offer

- Multicultural working environment
- Competitive salary
- Benefits by law

For complete information and application, please refer to:

https://eeas.europa.eu/delegations/albania_en

"Jobs & Funds" > "Jobs, Internships" > "Job offers"

Deadline for applications: 15/04/2018

Dyfishim i nxënësve në shkollën "Pavarësia", në Vlorë

Shkollat profesionale, Rama: Të rrisim kapacitetet, mundësi punësimi real

Brenda 3 vitesh, kapacitetet e shkollës profesionale Industriale "Pavarësia", në Vlorë janë dyfishuar e këtë vit numërohen plot 700 nxënës, në 5 profile të ndryshme. Kryeministri Edi Rama, i shoqëruar nga kryetari i Bashkisë së qytetit Dritan Leli, vizitoi dje këtë shkollë ku u takua me stafin e mësuesve, si dhe besideo me nxënës e prindër. "Ne tani, kemi aktualisht 700 nxënës në 5 profile të ndryshme. Mot do jemi të 800 nxënës dhe problem-in e kemi te kapacitetet.

DREJTORI I SHKOLLËS

"Ne tani, kemi aktualisht 700 nxënës në 5 profile të ndryshme. Mot do jemi të 800 nxënës dhe problem-in e kemi te kapacitetet. Jemi në kapacitetet maksimale. Në këto 3 vjet jemi 2-fishuar." - u shpreh drejtori i shkollës.

Jemi në kapacitetet maksimale. Në këto 3 vjet jemi 2-fishuar." - u shpreh drejtori i shkollës. Ky i fundit, gjithashtu, theksoi se një raport krejt tjetër është vendosur mes shkollave profesionale

dhe bizneseve që kërkojnë profesionistë pasi kërkesat për punësim nga bizneset janë rritur ndjeshëm e deri më tani janë rreth 70 kompani e biznese, të cilat bashkëpunojnë çdo ditë me

shkollat. Ndërkohë Kryeministri Edi Rama u shpreh se çelësi i ndryshimit është mënyra e re e funksionimit të shkollës, e lidhur ngushtë me kërkesat e tregut e shtoi se sfida e radhës mbetet shtimi i kapaciteteve. "Sistemi i bashkëpunimit me ndërmarrjet, i futjes së ndërmarrjeve në shkolla dhe i lidhjes së nxënësve me vendin e mundshëm të punës në ndërmarrje, është çelësi i gjithë ndryshimit. Tani problemi është të rrisim kapacitetin, edhe këtu, por dhe në



Rama në shkollën profesionale industriale "Pavarësia", në Vlorë

gjithë qytetet e tjera. Do ketë gjithmonë e më shumë kërkesa, sepse kanë filluar ta kuptojnë që kjo fushë do të ketë punësim real për shumë njerëz dhe prindërit sidomos kanë filluar të bëhen shumë të ndjeshëm. Plus që të kemi mundësi të

rrisim kapacitetin për trajnime të atyre që janë në mosha jashtë shkollore dhe që faktikisht shumë herë nuk dinë të bëjnë gjë, pavarësisht se kanë dëshirë për punë dhe refuzohen nga ndërmarrjet". - theksoi kreu i qeverisë.

Manastirliu: Rehabilitojmë Qendrën e Mirërritjes, u trajtuan 150 raste të reja në 2017-ën

Pagesa e KEMP-it, s'do të ketë më rikomisionim për fëmijët me autizëm


"860 persona të këtij spektri, 100 mijë lekë në muaj"

Voltiza Duro

Të gjithë fëmijët e spekrut autik apo me aftësi ndryshe, tashmë nuk do të përballen më me rikomisionimin e përvitshëm për marrjen e pagesës së KEMP-it. Kjo është deklaruar ditën e djeshme nga ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu gjatë vizitës në Qendrën Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve me probleme të neurozhvillimit, në ditën Botërore të Autizmit. "860 persona me autizëm trajtohen me pagesa në masën 10 mijë lekë/muaj dhe po të njëjtën masë pagesë përfitojnë edhe për shërbimin e ndihmës personale (kujdestarit). E kemi lehtësuar procedurën e përfitimit të pagesës nga KM-CAP. Sot personi me aftësi të kufizuara nuk paraqitet më në komision, pasi vlerësohet vetëm dokumentacioni që përmban dosja e tij. Për personat me autizëm nuk ka më rikomisionim të përvitshëm dhe kjo është një lehtësi e madhe për qindra prindër që çdo vit bashkë me fëmijët e tyre - që edhe ata duhet të paraqiteshin në komisionet kalonin një kalvar të vërtetë mundimesh", tha Manastirliu. Kjo e fundit më tej bëri me dije se në vijim do të garantohen kushte me standarde të larta për këtë kategori. "Në këtë ditë që na fton të gjithëve për më shumë vëmendje për fëmijët me çrregullime të spektrit autik, jam këtu për të lajmëruar rehabilitimin e plotë të Qendrës Kombëtare të Mirërritjes, e cila trajton rreth 330 fëmijë me autizëm në vit, nga të cilët 150 raste të reja të trajtuan në vitin 2017. Do të garantojmë kushte me standard të lartë për fëmijët



Ogerta Manastirliu gjatë vizitës në Qendrën Kombëtare të Mirërritjes, Zhvillimit dhe Rehabilitimit të Fëmijëve



PAGESA

"860 persona me autizëm trajtohen me pagesa në masën 10 mijë lekë/muaj dhe po të njëjtën masë pagesë përfitojnë edhe për shërbimin e kujdestarit. E kemi lehtësuar procedurën e përfitimit të pagesës nga KM-CAP. Sot personi me aftësi të kufizuara nuk paraqitet më në komision, pasi vlerësohet vetëm dokumentacioni që përmban dosja e tij. Për personat me autizëm nuk ka më rikomisionim të përvitshëm dhe kjo është një lehtësi e madhe për qindra prindër që çdo vit bashkë me fëmijët e tyre, kalonin një kalvar të vërtetë mundimesh", tha Manastirliu.

me çrregullime të spektrit autik dhe fëmijët me aftësi ndryshe". - u shpreh ministrja. Kjo e fundit, gjithashtu, bëri me dije se në vitin 2018 pritet të rekrutohen 7 mjekë në specializimin e fëmijëve

dhe adoleshentëve, ndërsa gjatë vitit 2019 pritet të mbarojnë studimet 5 specialistë të rinj. Ministrja Manastirliu deklaroi më tej se shërbimet do të zgjerohen edhe në 6 qendrat reziden-

ciale dhe 3 qendrat ditore publike në Shqipëri, të cilat trajtojnë fëmijë me çrregullime të spektrit autik.

STATISTIKA

Nga të dhënat në rang kombëtar, gjatë viteve të fun-

dit vihet re një rritje e numrit të fëmijëve që trajtohen në qendrat kombëtare të mirërritjes dhe në qendrat e tjera publike në vend edhe nën moshën 2-3 vjeç. Pjesa më e madhe vijnë me rekomandim të konsultorit të lagjes, një tregues ky që flet padyshim për rritjen e ndërgjegjësimit për çrregullimet e spektrit autik. Edhe nga të dhënat e shërbimit psikiatrik, numri i rasteve të reja në Njësinë e Psikiatrisë së Fëmijëve dhe Adoleshentëve është rritur (rreth 200 raste në vit), një rritje që sipas mjekëve lidhet me ndërgjegjësimin dhe evidentimin e rasteve që deri dje ishin të fshehura.

EVENTI



Veliaj: Është ulur numri i kafeneve dhe pikave të bastit

Viti 2017-të, për kryeqytetin shënoi uljen e numrit të kafeneve, apo të pikave të basteve si dhe rritin e numrit të terreneve sportive dhe bibliotekave. Kjo ishte një nga pikat kryesore mbi të cilat foli kryebashkiaku i Tiranës, Erion Veliaj gjatë zhvillimit të kampionatit "Survivor Games", një event outdoor që promovon jetesën aktive në natyrë me pjesëmarrjen 16 skuadrave. "Ish-të hera e parë që ra numri i kafeneve të reja, i basteve dhe i bingove, dhe u shtua numri i palestrave, i bibliotekave, i këndeve të lodrave dhe i terreneve sportive", theksoi Veliaj. Ky i fundit, i shoqëruar nga deputeti i PS, Eduard Shalsi, tha se Parku i Ligenit është kthyer në alternativë për shumë të rinj, për aktivitetet të ndryshme sociale e sportive. Ndërkohë, Shalsi inkurajoi kryebashkiakun Veliaj për të vijuar punën për Tiranën dhe shtoi se kryeqyteti është një model që duhet të ndiqet në të gjithë Shqipërinë.

Jaçaj: Hynë në test persona që nuk ishin shpallur fitues. Plaku: Testi, pa barkod

Skandali, përfundon studimet për mami, shpallet fituese tek infermieria

Bërdufi: Jam e zhgënjyer, është padrejtësi



Voltiza Duro

Vazhdon të thellohet skandali me portalin "Infermierë për Shqipërinë", i cili do të punësojë rreth 420 persona në degët infermieri, logopedi, mami, fizioterapi, imazheri e teknik laborator. Tri ditë më parë, të gjithë kandidatët që aplikuan në këtë portal e u shpallën fitues të raundit të parë për Qarkun e Tiranës, zhvilluan testimin me alternativa. Në një prononcim për "Gazeta Shqiptare", Morena Bërdufi tregon se i ka përfunduar studimet e larta për programin e studimit mami, por është shpallur fituese në degën infermieri në qarkun e Vlorës. "Jam super e zhgënjyer! Kam aplikuar në qarkun e Tiranës dhe Elbasanit për mami, pasi për këtë kam kryer edhe studimet. Pas shpalljes së listës së parë, rezultojta fituese për mami me 10.5 pikë, ndërsa në listën përfundimtare më kishte dalë emri fitues për degën infermieri në qarkun e Vlorës, ku unë nuk kisha aplikuar fare. Të shikojmë çfarë do bëjnë këta të Vlorës, se më ka dalë emri te infermiera. Kisha shpresa te portali për të filluar punë në profesion, por vetëm padrejtësi po shikoj", - tregon e drejtja. Më tej, Bërdufi tregon për "GSH" se në testin që u zhvillua në Tiranë nuk hyri, e shprehet e shqetësuar për faktin se duhet të japë provimin në datën 5 në Vlorë për infermierinë, në një kohë që ka përfunduar studimet për tjetër degë. "Cuditëm se në listën e parë isha e renditur afër më të mirëve, e tani s'dola as në fund. Se di çfarë të bëj se në Vlorë do më fusin të bëj provimin e infermierisë, nuk ka lidhje, është absurde! Shpresoj shumë që problemi im të marrë një zgjidhje sa më shpejt", - shton e reja. Ndërkaq, disa nga kandidatët që kanë zhvilluar testimin në qarkun e Tiranës tregojnë se fletët e provimit nuk kishin barkode. "Hapën kuitë e tezave para nesh, filloi provimi, u dorëzuan fletët të cilat nuk kishin barkode, as emër s'na lejohej që të vendosim në çdo faqe. Ndërkohë të faja e parë e testimit që shkruajtëm të dhënat tona, atë fletë e hoqën administratorët vëzhgues. Se si do bëhet identifikimi i fletës sonë s'e dimë, mbetet për t'u parë", - tregon për "Gazeta Shqiptare" Bajame Plaku, një prej të testuarave në degën e imazherisë.

QARKU VLORË

Lista e Kandidatëve Infermierë

Nr	Emër / Atësi / Mbiemër	Pikët
1	Edmond Nelo Hatika	24.3
2	File Halilaj	18
3	Margarita Aliaj	12
4	Redona Bari Beta	11.5
5	Edlira Ilmi Halilaj	10.5
6	Ermelinda Selfo Dukaj	9.7
7	Denisa Brahusaj	9.7
8	Aurela Viktor Seraj	9.6
9	Marinela Bedri Alushaj	9.6
10	Marsela Reshat Dami	6.4
50	Klarida Aben Xhaka	6.4
51	Mersin Veip Feinaj	6.4
52	Stiljano Zaho Dedaj	6.3
53	Martin Rahim Celi	6.3
54	Morena Kolë Bërdufi	6.3
55	Arber Llanaj	6.1
56	Etleva Caush Caushaj	6.1
57	Suela Asllan Novruzaj	8.4
	Valdet Zeqir Hoxhaj	8.3

MORENA BERDUFI

"Jam super e zhgënjyer! Kam aplikuar në qarkun e Tiranës dhe Elbasanit për mami, pasi për këtë kam kryer dhe studimet. Pas shpalljes së listës së parë, rezultojta fituese për mami me 10.5 pikë, ndërsa në listën përfundimtare më kishte dalë emri fitues për degën infermieri në qarkun e Vlorës, ku unë nuk kisha aplikuar fare. Të shikojmë çfarë do bëjnë këta të Vlorës, se më ka dalë emri te infermiera. Kisha shpresa te portali për të filluar punë në profesion, por vetëm padrejtësi po shikoj", - tregon Bërdufi.



REAGIMI NGA SHOQATA E INFERMIERËVE

Sipas kreut të Shoqatës së Infermierëve të Shqipërisë, Elson Jaçaj, portali i punësimit të infermierëve u duk

qartë që nuk ishte as mënyra e duhur dhe as në kohën e duhur. "Përveç zvarritjeve të njëpasnjëshme që u bënë disa herë si për dorëzimin e dosjeve, edhe për datat e testimit, tregoi qartë që vetë ata që e lançuan nuk ishin të përgatitur për mënyrën si duhej bërë. Burime të brendshme të vetë ministrisë pranuan që nuk e dinë ç'po po bëjnë me këtë gjë, pasi edhe pyetjet u morën vonë nga pyetjet e licencimit", - tregon Jaçaj për "GSH". Më tej, ai thekson se u konstatua që në listat e "fituesve", jo vetëm kishte emra të përsëritur disa herë, por kishte edhe nga ata që para një ose dy muajsh kanë filluar punë dhe rezultoni si persona fitues të fazës së parë për testim. "Ditën e testimit nga vëzhgimi që u bë, rezultoi të kishte emra që nuk ishin shpallur në listat e fituesve në portal. E gjitha kjo e hedh poshtë hipotezën që portali është një sukses dhe transparent. Për të mos folur më për pikët e vlerësimit që dolën shumë shpejt, ku njerëz me kualifikim të pikë minimale dhe ata pa eksperiencë dhe kualifikim, me pikë më të larta! Kështu që çdo gjë flet vetë se si do jetë fundi i këtij portali dhe kush do të jenë fituesit", - shton Jaçaj. Ndërkohë, disa prej të testuarave në datën 31



Foto ilustruese

BAJAME PLAKU

"Hapën kuitë e tezave para nesh, filloi provimi, u dorëzuan fletët të cilat nuk kishin barkode, as emër s'na lejohej që të vendosim në çdo faqe. Ndërkohë faqen e parë të testimit që shkruajtëm të dhënat tona, e hoqën administratorët vëzhgues. Se si do bëhet identifikimi i fletës sonë s'e dimë, mbetet për t'u parë", - tregon për "Gazeta Shqiptare" Bajame Plaku, një prej të testuarave në degën e imazherisë.



mars (kërkojnë të ruajnë anonimitetin) bëjnë me dije për "Gazeta Shqiptare" se në pyetjet e testimit për të gjitha kategoritë, pyetjet ishin rreth infermierisë dhe mamisë, pra ata që u testu-

ELSON JAÇAJ

"Ditën e testimit nga vëzhgimi që u bë, rezultoi të kishte emra që nuk ishin shpallur në listat e fituesve në portal. E gjitha kjo e hedh poshtë hipotezën që portali është një sukses dhe transparent. Për të mos folur më për pikët e vlerësimit që dolën shumë shpejt, ku njerëz me kualifikim të mirë rezultoni me pikë minimale dhe ata pa eksperiencë dhe kualifikim, me pikë më të larta! Kështu që çdo gjë flet vetë se si do jetë fundi i këtij portali dhe kush do të jenë fituesit", - shton Jaçaj.



an për fizioterapi, teknik imazherie etj., kishin të njëjtat pyetje rreth infermierisë, çka bie ndesh me profilin e tyre dhe me përgatitjen që ata kishin bërë për testim.

PARALAJMËRIMI



Revokim i lejeve për subjektet që shkaktojnë ndotje akustike

Të gjithë ata subjektet që do të shkaktojnë ndotje akustike gjatë sezonit të ri turistik, do t'u revokohet leja mjedisore. Ky është paralajmërimi që ka bërë ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, ditën e djeshme gjatë takimit me drejtuesit e bashkive në qarkun e Vlorës. Ai theksoi se për të pasur një transparencë dhe zbatim sa më të mirë të ligjit, të gjitha bashkitë duhet të përgatisin hartën e caktuar se ku duhet lejuar ose jo muzika. "Në qytetin e Vlorës, në qytetin e Sarandës, në Himarë, kudo ku kemi zhvillim turistik ka vende që mund të lejohen zhurmat, natyrisht për një grupmoshë të caktuar, por ka zona që nuk duhet të lejohen zhurmat dhe prandaj ne duhet të bëjmë një hartë për të caktuar qartë ku do të lejojmë që të kemi muzikë," - nënvizoi kreu i Turizmit e Mjedisit në fjalën e tij. Më tej ky i fundit bëri me dije se të gjitha subjektet që shkelin ligjin, do t'u revokohet leja e ushtrimit të aktivitetit. "Pra, ajo që ne duam të bëjmë gjatë këtij sezoni është që në bazë të planeve që do të përcaktojnë vetë bashkitë Ministria e Mjedisit do të revokojë lejet mjedisore për zhvillimin e aktivitetit në rast se zhurmat janë jashtë para parameleve të lejuara. Do të revokojmë lejen e ushtrimit të aktivitetit nga pikëpamja mjedisore atë që ne kemi target të fushës sonë për vendet që bashkia nuk lejon të zhvillohet aktivitet me një volum më të lartë akustik", - tha Klosi. Më tej ai shtoi se këtë vit pritet një turizëm cilësor, i cili kursesë nuk mund të jetë me zhurmë e theksoi se kjo është detyrë në bazë të ligjit e vetë bashkive, dhe do të monitorohet situata në mënyrë për të qenë sa më transparentë me biznesin.

SHKRIMTARET NE DIKTATURE DOKUMENTET

EKSKLUZIVE / Zbulohet raporti sekret i Dhimitër Fullanit, shefi i redaksisë së poezisë, dramës dhe kritikës në shtëpinë botuese "Naim Frashëri" për poetët me ndikime dekadente

Letra për Ramizin: Shuteriqi lejoi botimin e librit me ndikime dekadente të Arapit

Raporti i Fullanit: U desh ndërhyrja e shokut Enver që vëllimi të mos binte në duar të lexuesit

Dashnor Kaloçi

Menjëherë pas fjalimit të Enver Hoxhës më 15 dhe 16 mars të vitit 1973 në aparatën e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Shqipërisë, ku si temë kryesore ishte: "Lufta kundër shfaqjeve të huaja dhe liberale në art kulturë dhe ndikimi i tyre në të gjithë jetën e vendit", ashtu siç kemi parë edhe në mjaft nga kapitujt e tjerë të këtij libri, në të gjitha institucionet kulturore dhe artistike të vendit, organizatat bazë dhe komitetet e partisë së rretheve, u mbajtën një sërë mbledhesh me analiza të shumta ku u "punua" fjala e Enver Hoxhës. Në këtë kontekst, edhe në Shtëpinë Botuese "Naim Frashëri", të gjitha redaksitë përkatëse të saj, iu nënshtruan një analize të hollësishme të punës që kishin bërë deri në ato kohë, jo vetëm me ato që ishin botuar, por edhe me veprat dhe vëllimet që nuk e kishin parë ende dritën e botimit për shkak të problemeve të tyre me "ndikimet e huaja". Lidhur me këtë bën fjalë edhe dokumenti që po publikojmë në këtë pjesë të librit, (materiali është shkëputur nga një dosje voluminoze me siglën sekret) i cili mban datën 19 prill 1973, dhe ku shefi i redaksisë së Poezisë, Dramës dhe Kritikës, Dhimitër Fullani, ka bërë një informacion për Komitetin Qendror, konkretisht për Ramiz Alinë, sekretarit përkatës që mbulon artin, kulturën dhe propagandën. (Ramizi nuk ka bërë asnjë shënim në dokumentin në fjalë, pasi siç duket ka qenë i kënaqur me punën e Fullanit). Në këtë raport-informacion, Dhimitër Fullani ka analizuar me detaje dhe hollësi të gjithë punën që ajo redaksi ka bërë gjatë gjithë vitit 1972 me botimet në gjimnë e poezisë. Kështu ai ka marrë në analizë një numër të madh poetësh duke kaluar në një "sitë të imtë" të gjithë punën e tyre dhe duke bërë një spastrim të thellë në të gjitha vëllimet poetike të vitit 1972. Ajo që bie në sy në raport-informacionin në fjalë, është se "spata" e shefit të redaksisë së Poezisë, Dramës dhe Kritikës, Dhimitër Fullani, ka rënë "pa mëshirë" jo vetëm ndaj poet-



Dhimitër Shuteriqi, kryetar i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në studion e tij

ëve, duke filluar nga ata më me përvojë dhe deri tek më të rinjtë, por ai ka kritikuar edhe Kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Dhimitër Shuteriqin, i cili kishte lejuar dhe nxirru botimin e vëllimit poetik "Më jepni një emër", të Fatos Arapit, libër, i cili u ndalua që të dilte në qarkullim. Jo vetëm kaq, por Fullani nuk ka nguruar që në raport-informacionin e tij të pasqyrojë me hollësi edhe përplasjet që ai ka pasur "për shkak të detyrës" me Fatos Arapin, poetin që edhe pse "vinte nga Lufta" mbeti "problematic" në krijimtarinë e tij deri në fundin e viteve '80-të kur dhe u shemb regjimi komunist. Për më shumë rreth kësaj, na njeh raport-informacioni në fjalë që po e publikojmë të plotë në këtë pjesë të librit.

RAPORT

Mbi rezultatet e rishikimit të materialeve të redaksisë pas fjalimeve të shokut Enver



Ramiz Alia



Fatos Arapi në vitet '60

Sipas udhëzimeve që na u dhanë, redaksia e poezisë, dramës dhe kritikës letrare i kontrollon një për një të gjitha veprat që kanë qarkulluar gjatë vitit 1972, veprat që ndodhen në shtypshkronjë si dhe ato që janë duke u përgatitur për shtyp në redaksi dhe doli me këto të dhëna, mendime dhe konkluzione:

1. Për veprat e qarkulluara gjatë vitit 1972

Nga 55 vepra poetike, dramaturgjike dhe kritike të qarkulluara gjatë '72-shtit redaksia jo vetëm që nuk gjeti asnjë të pabotueshme plotësisht, por vetëm aty këtu ndonjë poezi që mund të mos ishte botuar për qartësi të pamjaftueshme të shprehjes figurative dhe mendimit poetik ose për ndonjë ekuivok në përmajtje. Po rëndisim këto raste duke u ndalur konkretisht tek secili:

a) Sulejman Mato "Mbi glob fryjnë erëra". Tri poezi si "Shtylla e tensionit", për figuracion alogjik, jo funksional, si dhe dy poezi të

“
Së shpejti libri më i ri, "Shkrimtarët dhe artistët në diktatin komunist" të gazetarit dhe studiuesit të njohur, Dashnor Kaloçi

tjera "Kumparista", dhe "Mirazh" për frymën sentimentale, nuk duhej të ishin futur në vëllim, siç mbetën jashtë këtij vëllimi, veç jershave të paarrira artistikisht, edhe poezitë me gabime ideore "Asma Kipters", "Një burokrat", "Pëllumbi i mikkuptimit u zgjua përsëri", "Vargje për kanarinat" etj.

b) Agim Gjakova "Perspektivë", një nga vëllimet me tematikë të pasur sociale dhe me frymë revolucionare, por me prirje drejt një sitilli poetik jo shumë të qartë sa duhet, është seleksionuar nga redaksia duke lenë jashtë mjaft vjersha të këtitlla, megjithëse aty këtu si të poezitë "Endërrim" (për aksionet me goditje të përqëndruar), dhe "Dielli" (lirikë erotike) përmbytja kapet me vështirësi, prandaj të mos ishin futur në vëllim.

c) Natasha Lako "Marsi brenda nesh". Duhej të ishte hequr poezia "Ndarja" me figura manieriste.

ç) Ylli Polovina "Nëpër stacione". Mund të mos e përmante poezinë "Largimi", që mbetet vetëm tek një impresion i papërcaktuar.

d) Ndoc Gjetja "Rezatim". Një nga veprat më të shquara të vitit 1972, ka një poezi të vogël të titulluar "Përse", e cila më thellë qëlon mendimin konservator, që denon dhe e ndjek dashurinë me njerzore dhe më të bukur, d.m.th. dashurinë e pranueshme për moralin proletar, ndërsa për ligji vese të tilla si grindjet e sharjet publike, por ka rrezik të kuptohet nga lexuesi i zakonshëm si thirrje për t'u puthur rrugëve. Kjo poezi mund të ishte hequr nga vëllimi.

I. Nga veprat e kësaj redaksie që ndodhen në shtypshkronjë



1) Miho Gjini "Pas shfaqjes" (Redaktor i jashtëm, Gjergj Vlashi, vëllimi i hedhur në shtyp që në vitin 1971).

Kjo përmbledhje artikujsh mbi problemet e estradës sonë pas fjalimeve të fundit të shokut Enver, duket qartë që është e mangët dhe e njënjëshme. Estrada është parë gjatë e gjërë, shpesh edhe thellësisht thuajse lidhur vetëm me misionin e saj në luftë kundër konservatorizmit dhe mbeturinave të së kaluarës në ndërgjegje, zakone, koncepte, etj. Në këtë drejtim libri sjell një kontribut të veçantë, do të thonim, të vetmin kontribut për orientimin e punës së këtij sektori të rëndësishëm të humorit dhe të satirës sonë si armë tepër efektive e Partisë së fuqisë të veçantë të fshikilluese dhe edukuese në masë, aq më tepër se problemet janë ngritur drejtpërdrejt nga aktiviteti i gjallë i tërë veprimtarisë sonë estradeske dhe janë ilustruar me shembuj konkretë për fenomenet pozitive ashtu edhe për ato negative.

Por tani, kur shoku Enver thekson si rrezik kryesor ndikimin e huaj borgjez dhe revizionist, ky libër, që i njeh estradës për detyrë thuajse vetëm luftën kundër fenomenëve konservatore dhe nuk e ka drejtuar vështrimin kritik veçse fare pak drejt trajtimit të ndikimeve të huaja borgjezo-revizioniste nga estradat, e humb vlerën e botimit. Aty këtu hidhet ndonjë mendim për ndonjë çështje të kësaj natyre, bëhet ndonjë kritikë krejt e rastit për trajtimin e dobët të kësaj çështje të estradës, por kurrë nuk ngrihet parimisht si problem i veçantë dhe kryesor lufta kundër ndikimeve të huaja borgjeze dhe revizioniste si detyrë e dorës së parë e estradës.

Në fq. 77 autori thotë: "Në të vërtetë e vjetra paraqet formën kryesore të shfaqjes komike". Në një rast tjetër në fq. 90, "Ajo (Estrada) e sheh zhvillimin dialektik të realitetit në aspektin e ndeshjes së të kundërtave, të kontrasteve të jetës, të deformimit të karaktereve dhe, tall e demaskon, makon çdo gjë të vjetër që na del si ferrë përpara. Dhe këtë realitet, Estrada e fikson me anë të materialeve humoristike e satirike, të cilat krijojnë përmbajtjen ideo- ➔



Enver Hoxha gjatë një takimi me shkrimtarët dhe artistët në vitin 1963

emocionale të saj. Në këtë përmbajtje derdhet vetë jeta, dinamizmi i kohës dhe fryma revolucionare në përcëllimin e veseve, të zakoneve të perënduara dhe të mbeturinave në ndërgjegje. Kjo është dhe kërkesa e parë e artit të estradës".

As tek artikulli i parë, që shërben si introdukt i këtij vëllimi, ku ngrihen në vija kryesore detyrat e estradës, as edhe tek artikulli "Arti i estradës në shërbim të luftës kundër imperializmit dhe revizionizmit", problem i luftës kundër ndikimeve, që duhej të kish zënë vendin kryesor, nuk është përmendur dhe autori është marrë vetëm me problemin e demaskimit të realitetit të atyre vendeve nga Estrada jonë.

Ky libër, pra, që, një sektor artistik dhe ideologjik të estradës e shikon dhe e vlerson më njëanëshmëri të këtyre, kur vetë Partia ngre problemin e rrezikshmërisë kryesore nga ndikimi i huaj borgjezo-revizionist, është çorientues dhe i dëmshëm për estradat dhe lexuesin.

2) Libri i Fatos Arapit, që fenomeni kulminant në ndikimit të poezisë dekadente të vendeve borgjeze

e revizioniste, që me shumë vësh-tirësi, por më në fund çau rrugë edhe në këtë redaksi. Megjithëse kjo çështje është bërë e njohur tanimë dhe libri u pezullua në kohën e duhur, shihet e nevojshme të përmendet, sepse ky rast përfaqëson një moment presioni të gjithanëshëm të atmosferës liberale kundrejt modernizmit, të cilin nuk e frenuam dot as ne.

Këtë vëllim "Më jepni një emër", e redaktoi në variantin e parë, Adriatik Kallulli dhe i bëri një recension panegjrik Dritëro Agolli. Pasi redaksia ja ktheu me

vërejtje të thella, gati të tëra vjershat e cilësuar prej nesh si të pabotueshme, autori i botoi të "Drita", "Nëntori", "Ylli", "Zëri i Rinisë", "Shqiptarja e Re". Më vonë e riktheu vëllimin në redaksi gjoja të ripunuar.

Redaksia e rishqyrtoi variantin e dytë të ripunuar dhe, me që nuk u bind për botimin e një vëllimi të këtyre poetik, i cili do të launte një rol orientues negative për krijimtarinë tonë poetike, u këshillua me Kryetarin e Lidhjes së Shkrimtarëve, shokun Dhimitër Shuteriqin si dhe me shokun Hamid Beqen dhe ata mendonin se nuk duhej penguar botimi i librit për shkak të stilit hermetik të autorit, por të qërohej vëllimi nga ekuivoket. Nga njëra anë vetë autori me një fushatë shpifjesh e denigrimesh kundër Dhimitër Fullanit, më anë tjetër kundërvënia e shtypit letrar si Kudert Velçës, Dhan Shaplos e të tjerëve kundër frenimit të kësaj veprë për shtyp, na detyroi (Dhimitër Fullanin, Vëhbi Skënderin dhe Ali Abdihoxhën, që vetëkuptohet se mbajnë përgjegjësinë kryesore), t'i shihnin vjershat e këtij vëllimi një për një me tolerancë që i imponohej nga opinioni derisa ta hidhnin vëllimin në shtyp.

Edhe pasi u hodh në shtyp, redaksia e pati kundrohë në dyshim këtë vëllim. Në raportin vjetor të vitit 1972, ndërsa libri ishte në shtyp, lidhur me këtë vëllim shënohej: "Megjithëse ky vëllim më në fund u hodh në shtyp më tepër nga presioni i organeve periodike, të cilat i botuan poezitë e tij, se sa nga ripunimi që i bëri autori sipas vërejtjeve tona, unë, si shef i redaksisë kam bindjen se kjo veprë, pavarësisht nga meritat përfaqëson një tendencë drejt një poezie me përmbajtje të paqartë, në kundërshtim me kërkesën kryesore për qartësi të artit tonë për masat, mbasi mendimi poetik nuk mund të jetë i thellë kur është i errët e i paqartë, por mund të jetë i thellë edhe duke qenë i qartë. Në emër të së drejtës

"Në ogranjë", (ekuivok). "Dashuri në pullas", (banalite). 2. Nga vëllimet e përgatitura për shtyp të redaktorit, Vëhbi Skënderi.

a) Prej vëllimit të Mitrush Kutelit "Baltë nga kjo tokë", u hoq vjersha "Balada e vogël e syrit të zi", ku tragjizmi i kurbetit më 1964, kur është shkruar vjersha, nuk përligjet në vendin tonë.


b) Prej vëllimit të Frederik Reshpes "Në këtë qytet", u hoqën dy poezi "Muzeu i fshatit" ku përshkon një notë tragjike, ndërsa përkujtohet Lufta N.Ç.I dhe zë nga femijria, që të krijon përshtypjen sikur koha jonë i ka errësuar idilet e femijerisë. (ekuivok).

c) Prej vëllimit të Shefki Karadakt "Ylberi", u hoqën tri libra me një pejsazh pasiv.

ç) Nga vëllimi i Aleks Çaçit "Fjalë të bardha" u hoq vjersha "Foleja e shqiponjës", që ep shkas gjithashtu për ekuivok.

d) Nga vëllimi i Gjergj Zhejit "Artisti dhe jeta", përgatitur për shtyp nga redaktori Dilaver Dilaveri do të hiqet dhe do të zëvendësohet vetëm artikulli: "Kritika dhe teoria" ku autori, në emër të kërkesës bën thirrje për ta lidhur kritikën me teza të gabuara si ato të diskutimeve të gazetës "Drita" rreth romanit, që çënonin disa nga parimet bazë të realizmit socialist lidhur me heroin pozitiv etj.

III. Redaksia e rishikoi dhe po i rishikon gjithashtu të tërë materialet që ka në process duke shkarkuar nga vëllimi i Harallamb Qeskos, poezinë e cikërimave peisazhiste dhe erotike përshkuar nga një idil romantik i kaluar, nga poezi me figuracion kapricoz e alogjik, me përmbajtje të paqartë, nga vëllimi i Faslil Halitit ndonjë poezi me nëntekst të paqartë dhe ekuivoke, nga ai i Hiqmet Meçes poezitë jo të pakta me stil të errët, fragmentar dhe ekuivoke, nga ai i Xhevahir Spahiu ekuivoket dhe gabimet ideore dhe u bëri kështu një pastrim me rradhë vëllimeve poetike të Vasil Koçit, Mira Zajmit, Thanas Mustaqit, Llambro Rucit, e të tjerëve, duke pasur parasysh jo vetëm nevojën e spastrimit nga poezitë e prekura nga ndikimet e huaja dhe të pareaalizuar sa duhet, por edhe kërkesat për pasurimin e këtyre veprave me tematikë të shëndoshë sociale, revolucionare, që botimet tona poetike të shërbejnë si stimul i një zhvillimi të ri të krijimtarisë sonë poetike në rrugën e shëndoshë të Partisë.



Godina e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve në vitet '60



Fatos Arapi, Skifter Këlliçi dhe Agim Cerga gjatë një mbledhjeje, Tiranë 1972

Tani që i zbuluam me rrenjë këto ndikime nëpër botimet tona nën dritën e fjalimeve të fundit të shokut Enver, bile duke gërmuar thellë e më thellë, le të shohim realisht dhe me argumentime të paritshme sa kujdes kemi patur ne për t'i përballur këto ndikime, sa peshon faji ynë dhe i secilit prej nesh lidhur me këto lëshime në krahasim edhe me institucionet e tjera botuese duke pasur parasysh edhe faktin e pamohueshëm se sa i kishte përligjur këto lloj lëshimesh e shkarjesh atmosfere liberale e krijuar dhe sa i kemi rezistuar ne asaj.

E vërteta është se redaksia i ka diskutuar fenomenet e reja poetike që në fazën embrionale dhe i ka inkurajuar anë e tyre pozitive, por ka frenuar prirjet negative, që i bien ndesh me estetikën marksiste dhe me kriteret bazë të Partisë sonë në fushën e letërsisë dhe këto çështje i kemi dokumentuar qart nëpër analiza vjetore të redaksisë.

(vijon nesër)

Agjencia e Trajtit të Pronave: Përfituesit kanë edhe 4 muaj kohë për të plotësuar dokumentet

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtit të Pronave ka përfunduar procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare për dosjet e vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara në të gjithë vendin. Në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, u identifikuan gjithsej 1462 vendime të vitit 1997, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikat në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje. Numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara

Lista VII/ Vendimet e vitit 1997, emrat e 1462 pronarëve që kompensohen

Kanë njohur të drejtën e kompensimit për vitet 1993-1997 rreth 17 318 vendime

dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP-ja është 17 318 vendime. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë me përfituesit e vitit 1997 së bashku me vlerën financiare.

MUNGESA E DOKUMENTACIONIT

Sipas ATP-së, në rastet kur subjektet e interesuara nuk sjellin dokumentacion të nevojshëm për vlerësimin financiar të vendimit të kompensimit brenda afatit 6-mujor nga data e publikimit të regjistrit, si dhe në rastet

kur ATP-ja është në pamundësi objektive për të vlerësuar pronën, bazuar në dokumentacionin që disponon vendimi i kompensimit vlerësohet financiarisht. Pronarët kanë edhe 4 muaj kohë për plotësimin e dokumenteve dhe ATP njofton të gjitha subjektet, që për çdo informacion apo paqartësi lidhur me të dhënat e publikuara në regjistrë apo që nuk i gjejnë të publikuara në të, mund të paraqiten pranë sporteleve tona për sqarime dhe informacion më të deta-

juar. Gjithashtu, ATP ka filluar punën dhe së shpejti do të përfundojë procesin e vlerësimit financiar të vendimeve përfundimtare të vitit 1998 dhe në vijim sipas rendit kronologjik do të vlerësohen të gjitha vendimet, të cilat kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

DOSET E PËRFUNDUARA

Me përfundimin e procesit të vlerësimit financiar të

vendimeve përfundimtare të vitit 1997, si dhe nga përditësimi i regjistrit të vendimeve për vitet 1993-1996, numri total i vendimeve të viteve 1993-1997, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që janë vlerësuar financiarisht e publikuar nga ATP është 17 318 vendime. ATP nga hyrja në fuqi e Ligjit nr.133/2015 e deri më tani ka përfunduar vlerësimin financiar për 67%

të të gjithë vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Me ecurinë e punës së deritanishme, kjo falë edhe sistemit "Web-Gis" të implementuar nga ATP, ky proces parashikohet të përmbyllet përpara afatit të përcaktuar në ligj për përfundimin e vlerësimit financiar të të gjitha vendimeve përfundimtare, që kanë njohur të drejtën e kompensimit.

EMRAT E 1462 PRONARËVE QË KOMPENSOHEN

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	VLERESIMI
(Vijon nga numri i djeshëm)			
Korçë	Hajdhica Bice		267,528
Korçë	Qazim Seitlari		69,280
Korçë	Gjergji Kristaq Mehilli		355,029
Korçë	Fidarije Abasllari		134,954
Korçë	Lavdie Alinji		244,710
Korçë	Elmije Begollari, Kame		187,356
Tiranë	Shaban Dervishi		757,935
Tiranë	Shqipe Lecini(Habili)		2,236,400
Korçë	Ibrahim Spaho		
Korçë	XHEMAL HAMETLLAR		-54,272
Dibër	ISUF KLOSI		259,552
Dibër	SHEFIKATE MUCA		219,474
Durrës	Margarit Çumashi		
Dibër	Bajram Zeqiri		302,102
Gjirokastrë	Bekim Sula		299,063
Berat	Xhezo Shyqo Bako		
Gjirokastrë	Namik Cami		
Korçë	Hysen Ibro		-587,000
Korçë	Iljaz Kalemi		-156,400
Korçë	Fatime Haderllari		
Korçë	Fuat Kelo		311,984
Korçë	Xhafer Sulollari		5,000
Korçë	Thomaq Prifti		-79,840
Korçë	Vaske Kolaci		0
Korçë	Fatime Hadërllari		431,962
Korçë	Radium Avxhi		1,139,155
Korçë	Ademije Mulla		1,396,985

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	VLERESIMI
Korçë	Vangjeli Bendo		108,000
Berat	Hysen Musabelliu		1,353,163
Berat	Adriatik Caka		776,233
Berat	Adriatik Caka		132,956
Berat	MEDI MYRTO LULAJ		0
Gjirokastrë	Hysen Daut Shehu		
Berat	Lule Lullollari		601,406
Berat	Lule Lullollari		784,272
Korçë	Shaban Male		743,040
Korçë	Shaban Male		1,068,693
Shkodër	Vishe Germaj		299,004
Shkodër	Jusuf Sylo Balidemaj		
Shkodër	Geg Gjin Prendi		756,996
Shkodër	Nikoll Mark Deda		408,067
Shkodër	Hysen Gerberti		145,834
Shkodër	Daut Loku		411,743
Fier	Bajram Avdia		
Fier	Hekuran Alliaj		
Fier	Pëllumb Toro		3,856,461
Fier	Nadir Ferko		5,064,357
Fier	Vangjel Stroni		6,554,638
Fier	Refat Meraj		145,286
Fier	Hamit Baxhia		4,575,198
Fier	Nasi Shkurti		
Fier	Rrapi Mici		
Fier	Banush Shateraj		5,657,346
Fier	Feim Rustemi		2,579,405
Gjirokastrë	Eqerem Dashaj		

Qarku	Emri (Subjekti Kerkues)	Atesia	VLERESIMI
Gjirokastrë	Reshat Hyseni		1,841,814
Gjirokastrë	Muhamet Veizi		489,386
Gjirokastrë	Sefer Matohiti		
Gjirokastrë	Bylyre Luzaj		
Tiranë	NUREDIN KAMBERI		
Tiranë	HEKURAN HASA		0
Tiranë	AISHE HOXHA		0
Tiranë	KASEM ISMAILI		-2,115,200
Tiranë	SHAQIR ALLA		4,066,450
Tiranë	QERIM GURZI		1,170,000
Gjirokastrë	Nezet Shehu		1,030,092
Fier	Asllan Malaj		2,112,584
Gjirokastrë	Dilfo Spahaj		483,112
Tiranë	Ramazan Çollaku		375,536
Tiranë	Meleqe Gjoni		1,155,903
Gjirokastrë	Xhelal Resuli		
Gjirokastrë	Hasime Ballaxhij		175,259
Berat	Neim Sali Saçdanaku		836,557
Durrës	Gëzim Balla		6,898,545
Durrës	Muharrem Kota		1,622,267
Elbasan	JAKUP PRECI		
Gjirokastrë	Bejaze Mataj		
Dibër	RAMAZAN SARACI		927,010
Gjirokastrë	Dilaver Jaup Divintari		335,276
Gjirokastrë	Maliq Xhelo Hyseni		694,816
Gjirokastrë	Skendo Jaho Sina		329,394
Gjirokastrë	Demir Meraj		1,930,968
Gjirokastrë	Servet Dervishi		

Tiranë	HAJDARI		
Tiranë	HASAN RAMAZAN BOGDANI		
Tiranë	XHAVIT DIBRA		
Tiranë			1,918,812
Tiranë	ZYDI SHIJAKU		
Tiranë	THACI		
Korçë	Lytfi Berberi		
Elbasan	ADHURIM KAOLI		
Elbasan	MEHMET BALLKOCI		256,881
Gjirokastër	Hajri Bilo Llakaj		773,007
Korçë	Feim Pasho		1,096,875
Durrës	Nazmi Shehi		
Lezhë	Mark Frrok Gjeci		686,944
Lezhë	Preng Mark Prenga		282,129
Lezhë	Dede Ndue Gjeci		
Lezhë	Pashk Nikoll Prendi		
Durrës	Ramazan Çopa		
Durrës	Vjollca Dedja		4,407,000
Korçë	Mitat Mero		
Durrës	Vita Mazniku		-530,400
Gjirokastër	Shaje Allkaj		
Durrës	Abdulla Shehi		
Korçë	Nevruz Subashi		2,054,088
Fier	Llazar Koço		2,072,317
Fier	Sokrat Naçi		3,121,119
Fier	Ndoni Silo		6,089,030
Fier	Nimete Mala		
Fier	Refat Selfo		2,021,021
Fier	Hidajet Mala		1,170,475
Fier	Hysen Malaj		
Fier	Miti Janku		8,591,494
Korçë	Mitika Uci		
Korçë			477,960
Lezhë	Gjyste Leshi		387,251
Fier	Nikollaq Llço		
Durrës	Hamid Balla		2,738,574
Gjirokastër	Neim Barjam Kanani		1,505,811
Fier	Tahir Kallëmbi		
Durrës	Rifat Shkodra		6,840,147
Durrës	Ismail Meça		10,504,858
Durrës	Hatixhe Dani		649,782
Korçë	LUAN KOLAMI		-232,552
Korçë	Teki Gegolli		
Korçë	Eqerem Avxhi		103,530
Dibër	BARDHYL KADIU		3,088,739
Lezhë	Frok Llesh Rec		-2,768,525
Lezhë	Gjon Mark Rec		2,845,484
Tiranë	Besnik Bashmeta, Halil Bashmeta		
Tiranë	RAMIZ CELA		329,000
Tiranë	XHEMILE MALIQATI		3,948,000
Tiranë	HAMIDE KOKA		
Tiranë	Kadife Dedej(Dervishi)		723,552
Tiranë	MEREME XHAHYSA (K)		414,829
Tiranë	Drita Gashi, Feride Gas		1,570,913
Tiranë	ANISHA HENCI		3,190,836
Tiranë	Mereme Hoti (Boletini),		1,197,704
Tiranë	Sadete Hadja, Shyqyri H		2,585,000
Tiranë	FATIME, OLIMBI, KUM		7,502,418
Tiranë	HATIXHE CELPICA		3,026,800
Tiranë	Ali Thertori		659,569
Tiranë	Haxhi Hallulli, Shefqet H		1,826,812
Tiranë	Arta Fagu		3,424,805
Tiranë	Ramiz Çela		458,066
Tiranë	Ramiz Cara		5,317,211
Dibër	Qemal Allamani		2,055,808
Korçë	Hasan Emin Skerma		2,551,030
Vlorë	Astrit Kallapodhi		
Korçë	Zikuli Karanxha		55,987
Dibër	Ramazan Ceku		
Korçë	Yzret Meço		232,068
Korçë	Viktor Konomi		-12,669
Vlorë	Myzejen Zejnati		
Fier	Shefqet Buzi		7,682,923
Fier	Thoma Haxhistasa		
Fier	Thanas Duda		9,173,566
Fier	Bilbil Kerri		
Fier	Hysen Çoçoli		
Fier	Përparim Alizoti		3,121,268
Gjirokastër	Spartak Xhuvani		-413,340
Gjirokastër	Shezai Shehu		323,182
Gjirokastër	Kristaq Çipi		
Gjirokastër	Foni Dilo		73,800
Korçë	Gurtali Fezulli		
Korçë	Kostandina Ktona		
Korçë	Xhevdet Dervishi		675,710
Korçë	Kujtim Demko		99,500
Korçë	Shpëtim Çausllari		254,400
Korçë	Ropi Shurdhi		-18,458
Korçë	Ibrahim Qose		240,000
Korçë	Novruz Pino		190,000
Korçë	Vangjel Pelteku		773,500
Korçë	Shpetim Iliri		400,000
Elbasan	MUHAMET GJONI		165,749
Elbasan	XHEMAL STOJKU		1,633,731
Korçë	Kadrije Agolli		219,272
Korçë			1,010,000
Elbasan	DEMIR REXHEPI		
Vlorë	Koco Kristo		
Vlorë	skender Godo		
Korçë	Vasfi Staro		
Korçë	Gurali Dervishllari		
Korçë	Vasfi Nevruz		3,924,912
Vlorë	Vasil Dharmi		54,912
Korçë	Emin Bregu		604,426
Korçë	Hysen Shahinllari		971,399
Shkodër	Trashgimtarët e Jakup Sal		831,485
Shkodër	Trashgimtarët Elez Can L		117,185
Elbasan	NIGJARE BARDHOSHI		109,646
Berat	Nazmi Shahu		25,904
Berat	Nazmi Shahu		1,222,329
Berat	Bahije Tusha		
Berat	Gëzim Braho		1,134,109
Berat			863,465
Berat	Shkëlqim Musabelliu		314,411
Berat	Shkëlqim Musabelliu		584,781
Korçë			71,955
Korçë	Nihat Sulkollari		9,922,182
Korçë	ALBERT ÇORBAXHIU		179,276
Korçë			6,807,671
Korçë	Pandi Berberi		17,989
Korçë	Gazmend Çorbaxhi		-699,553
Korçë			-2,749,119
Kukës	Azem Hoxha		
Kukës	Ramazan Muça		
Korçë	Hasan Bajko		1,325,899
Kukës	Sahit Xhebexhia		
Lezhë	Llesh Preng Kacorri		
Lezhë	Zef Ded Brunga		
Lezhë	Preng Ded Deda		
Korçë	LIRIKA KANE		233,280
Korçë			59,110
Dibër	XHEHAL STANA		
Korçë	Mystek Xhixho		-88,100
Korçë	Kasëm Jaupi		-78,200
Dibër	ISMAIL MUHARREMI		1,370,352
Korçë	Livi Shanazo		
Dibër	BAJRAM ÇEKU		2,151,993
Dibër	SALI DEDOLLI		926,275
Korçë	Njazi Potomi		37,000
Dibër	HAMIT LETI		83,000
Dibër	SELIM HASA		1,569,657
Dibër	AHMET BOZA		752,448
Dibër	Hajrulla Dishani		236,311
Dibër	Hamit Metuku		855,863
Elbasan	TODI SULONJAKU		
Elbasan	MEHMET BARDHI		
Fier	Vath Buzi		2,999,743
Fier	Ylber Doda		11,087,620
Fier	Razie Kumani		25,622,590
Fier	Dashamir Balla		7,886,774
Fier	Zylfie Gashi		855,470
Fier	Xhemal Beqiri		
Fier	Donika Çoçoli		
Fier	Xhumuret Vlshaj		3,595,031
Fier	Gjylo Lako		1,421,291

Fier	Kadri Kodheli	5,796,640
Fier	Ylberë Doda	232,508
Korçë	Emine Tarelli	1,705,582
Korçë	Kiço Filo	44,258
Lezhë	Prena Mark Kola	
Lezhë	Gjon Koli Perkeçi	383,762
Lezhë	Preng Ndue Dushku (Niko)	603,466
Lezhë	Preng Nikolle Ndoji	41,254
Vlorë	Mynyr Cobo	50,400
Lezhë	Frrrok Kole Perkeçi	383,762
Elbasan	DHIMITER TOCI	8,149,327
Fier	Hysen Nazeraç	858,833
Fier	Kujtume Xhafaj	
Fier	Hekuran Bideri	
Fier	Barjam Barjami	
Fier	Kaso Zotaj	
Fier	Nateme Veliaj	-550,000
Fier	Jonuz Brahimaj	
Fier	Muharrem Avdiaj	
Korçë	Ollga Tabaku	1,807,110
Korçë	Qerim Nake	121,088
Vlorë	Mukadez Sulejmani	94,160
Vlorë	Neshat Osmani	363,440
Berat	Iljaz Metani	1,292,114
Lezhë	Llesh Preng Kacorri	
Lezhë	Zef Ded Brunga	
Lezhë	Preng Ded Deda	
Korçë	LIRIKA KANE	233,280
Korçë		59,110
Dibër	XHELAL STANA	
Korçë	Mysteak Xhixho	-88,100
Korçë	Kasëm Jaupi	-78,200
Dibër	ISMAIL MUHARREMI	1,370,352
Korçë	Livi Shanazo	
Dibër	BAJRAM ÇEKU	2,151,993
Dibër	SALI DEDOLLI	926,275
Korçë	Njazi Potomi	37,000
Dibër	HAMIT LETI	83,000
Dibër	SELIM HASA	1,569,657
Dibër	AHMET BOZA	752,448
Dibër	Hajrulla Dishani	236,311
Dibër	Hamit Metuku	855,863
Elbasan	TODI SULONJAKU	
Elbasan	MEHMET BARDHI	
Fier	Vath Buzi	2,999,743
Fier	Ylberë Doda	11,087,620
Fier	Razie Kumani	25,622,590
Fier	Dashamir Balla	7,886,774
Fier	Zylfie Gashi	855,470
Fier	Xhemal Beqiri	
Fier	Donika Çoçoli	
Fier	Xhumuret Vlshaj	3,595,031
Fier	Gjylo Lako	1,421,291

Korçë	Shefki Pillati	
Korçë	Emin Bregu	604,426
Korçë	Hysen Shahinllari	971,399
Shkodër	Trashgimtarët e Jakup Sal	831,485
Shkodër	Trashgimtarët Elez Can L	117,185
Elbasan	NIGJARE BARDHOSHI	109,646
Berat	Nazmi Shahu	25,904
Berat	Nazmi Shahu	1,222,329
Berat	Bahije Tusha	
Berat	Gëzim Braho	1,134,109
Berat		863,465
Berat	Shkëlqim Musabelliu	314,411
Berat	Shkëlqim Musabelliu	584,781
Korçë		71,955
Korçë	Nihat Sulkollari	9,922,182
Korçë	ALBERT ÇORBAXHIU	179,276
Korçë		6,807,671
Korçë	Pandi Berberi	17,989
Korçë	Gazmend Çorbaxhi	-699,553
Korçë		-2,749,119
Kukës	Azem Hoxha	
Kukës	Ramazan Muça	
Korçë	Hasan Bajko	1,325,899
Kukës	Sahit Xhebexhia	
Tiranë	GANI MURATI	
Korçë	Haki Kurili	585,923
Korçë	Nesti Kotmilo	747,823
Korçë	Jorgjia Thimo	703,108
Korçë	Vasilika Çekani	4,023,338
Korçë	Isa Bliri	770,855
Korçë	Ali Hasankolli	863,465
Korçë	Hysen Qerimi	878,884
Korçë	Ervehe Laze	646,057
Korçë	Nazliko Tefiku	1,460,901
Korçë	Pashako Shuli	426,922
Korçë	Mirash Zeqo	324,581
Korçë	Ali Petritaj	411,603
Korçë	RAKIBE PANE	0
Korçë	Leonidha Mujo	3,622,728
Shkodër	Kol Shiroka	533,498
Shkodër	Tonin Kromiçi	185,028
Shkodër	Zef Loro Kiri	
Shkodër	Hasan Radovic	959,406
Shkodër	Veneranda Paliku	616,761
Shkodër	Ballkiz Shehi	231,285
Korçë	Gurtali Fezollari	258,194
Korçë	Ibrahim Brame	514,899
Korçë	Vangjo Nune	1,083,443
Korçë	Mustafa Seit Mekellari	
Korçë	Sotiraq Terova	7,508,037
Korçë	Llazar Burnazi	
Korçë	Violeta Bajraktari	2,432,814

Gjirokastrë	Xhevit Çakalli	
Gjirokastrë	Isuf Çelo Rama	664,344
Gjirokastrë	Serafin Stavri	
Gjirokastrë	Qerim Pashaj	4,099,200
Gjirokastrë	Kostandin Rushitaj	
Tiranë	YLLI GJOKA	948,838
Tiranë	SEFER BALLA	2,357,228
Tiranë	HAMIT DEDJA	908,040
Tiranë	XHEMAL SULA	
Durrës	Selaudin Qesja	
Gjirokastrë	Kujtim Adem Laskaj	
Dibër	Islam Kazani	
Dibër	Ibrahim Pulja	
Vlorë	Pandora Zoto	
Gjirokastrë	Axhem Hazbi Bakaj	500,709
Gjirokastrë	Hajri Bilolllaka	2,033,715
Tiranë	ASLLAN CACA	256,730
Tiranë	KUJTIM SARACI	
Tiranë	TEFIK DUL ALIM	3,528,525
Tiranë	QERIME MEMA	
Tiranë	NAIM BEU	
Tiranë	Islam Recic	540,200
Tiranë	HUME FILE SUMA	1,545,642
Tiranë	Pellumb Vrapi	109,557
Tiranë	Mahire Pazari	9,751,889
Tiranë		1,645,000
Tiranë	Haxhi Lusha	3,343,627
Tiranë	Hasan Ceka, Jashar Ceka	2,840,889
Tiranë	Remzije Kraishita, Shahe	1,133,927
Tiranë	Ali Tirana, Lila Tirana	907,425
Tiranë	HANE BODLLI	1,271,547
Tiranë	Fitnete Sinka, Nexhip Ali	1,929,626
Tiranë	MAIRA PAZARI	3,893,056
Tiranë	SULEJMAN KEZI	
Tiranë	ANDREA GANI	
Tiranë	QAZIM, ABAZ, FADIL E	1,159,415
Tiranë	Drita Merkja, Mehmet Merkja	
Tiranë	Isuf Rosa	741,137
Tiranë	Merita Becerri, Vasip Becerri	
Tiranë	Zyber Bushi	71,310
Gjirokastrë	Kanan Ali Dervishi	
Gjirokastrë	Pashako Guma	96,237
Dibër	RUSTEM VRANIÇI	
Dibër	BARDHYL MAZARI	106,375
Korçë	Hamit Kasolli	
Fier	Xhemil Haxhaj	
Gjirokastrë	Zonje Guma	
Korçë	Saip Biba	402,675
Tiranë	MUHARREM MAHMUD	-1,899,880
Tiranë	XHAFER DARDHA	-1,791,710

Media zvicerane: Kryeministri kosovar s'ishte në dijeni të deportimit

Erdogan kërcënon Haradinajn: Po të duam, të rrëzojmë qeverinë

Thaçi mohon të ketë dijeni, reagon Turqia

Hashim Thaçi ka gënjer publikisht qytetarët e Kosovës kur tha se nuk kishte dijeni për rrëmbimin e mësuesve turq nga shërbimi sekret turk me ndihmën e shtetit paralel të tijin dhe të Paçollit brenda strukturave qeverisëse". Gënjeshtërën e Thaçit e ka zbuluar ditën e djeshme presidenti i Turqisë, Erdogan gjatë një fjali me mbështetës të partisë së tij. Ai e falënderoi publikisht Thaçin për bashkëpunimin duke paralajmëruar se të njëjtin bashkëpunim për rrëmbimin e mësuesve të tjerë do ta kenë me presidentin e Kosovës edhe në vijim. "Jazëk të qoftë kryeministri i Republikës së Kosovës që shkarkove ministrin e Brendshëm dhe shefin e shërbimeve sekrete të Kosovës. Ndërkohë dua të falënderoj shumë presidentin e Kosovës, i cili ishte një bashkëpunëtor shumë i mirë. Po të duam ta rrëzojmë qeverinë dhe ke për ta pësuar me këtë që ke bërë. Në Kosovë do të bëjmë operacione të tjera të ngjashme me ndihmën e presidentit të Kosovës", tha Erdogan. Në këtë mënyrë, presidenti një shteti tjetër ndërhyr në mënyrë flagrante në punët e Kosovës duke kërcënuar se mund të rrëzojë apo ngrëjë kryeministrin dhe qeverinë. Pritet reagimi i Haradinajt, pasi ky është kërcënim i dytë publik i Erdoganit ndaj tij, ndërkohë që ka përshëndetur



Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan

RECEP TAYYIP ERDOGAN

"Hashim Thaçi ka gënjer publikisht qytetarët e Kosovës kur tha se nuk kishte dijeni për rrëmbimin e mësuesve turq nga shërbimi sekret turk me ndihmën e shtetit paralel të tijin dhe të Paçollit brenda strukturave qeverisëse", - ka thënë presidenti turk.

detur Thaçin për ndihmën që i dha në rrëmbimin e mësuesve turq. Ndërsa edicioni qendror i lajmeve, SFR, televizioni publik i Zvicrës, është marrë me krizën më të fundit në Kosovë, në të cilën është përfshirë lideri au-

tokrat turk, Recep Tayyip Erdogan. Në edicionin kryesor të lajmeve, televizioni publik zviceran SFR sollti një reportazh rreth ngjarjeve të fundit në Kosovë, respektivisht për debimin në mënyrë klandestine të shtetaseve

turq të enjten e kaluar. "Ish-turq një rrëmbim i vërtetë: pa urdhër të gjykatës dhe pa dijeninë e kryeministrit Ramush Haradinaj, policia e Kosovës arrestoi gjashtë mbështetës të dyshuar të lëvizjes Gylen duke deportuar në Turqi, përmes Aeroportit të Prishtinës", raporton SFR. Më tej shkruan se deportimi ndodhi me njohurinë e presidentit Hashim Thaçi. "Kosova ndjek dëshirën e udhëheqësit turk, Recep Erdogan Tayyip që e bën Lëvizja Gylen përgjegjës

për grusht shteti në tentativë në verën e vitit 2016". Sipas SFR, në Ballkan po ndodhin lëvizje të mëdha gjeopolitike, ndërmjet dy fuqive me ndikim, Turqisë së Recep Tayyip Erdoganit dhe Rusisë së Vladimir Putin. Loja po bëhet tejet e rrezikshme, sipas analistit Georg Häsler, kur kihet parasysh se BE është fare e pafuqishme kundër këtyre ndikimeve. Në raport u pasqyruan famillet e të dëbuarve dhe Hashim Thaçi, i cili mbrojti aksionin e shërbimit sekret turk.

MEDIA ZVICERANE

"Ishte një rrëmbim i vërtetë, pa urdhër të gjykatës dhe pa dijeninë e kryeministrit Ramush Haradinaj. Kosova ndjek dëshirën e udhëheqësit turk, Recep Erdogan Tayyip që e bën Lëvizja Gylen përgjegjës për grusht shteti në tentativë në verën e vitit 2016", - shprehej në median zvicerane, SFR.

SHKURT

Daçiç: Nuk lejojmë Kosovën të jetë pjesë e OKB

Ivica Daçiç, ministri i Punëve të Jashtme të Serbisë, ka thënë se nuk bëhet fjalë që Serbia ta njohë pavarësinë e Kosovës dhe ta lejojë atë të marrë një ulëse në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. Daçiç duke folur për TV 'Pink' ka thënë se gjithmonë ka punuar për Kosovën që të gjendet një kompromis që do të eliminojë shkaqet e konfliktit mes dy palëve. "Sjemi të interesuar në intensifikojmë problemin në këtë situatë, por të qëndrojmë të qetë dhe të implementojmë marrëveshjen e Brukselit", - pohoi Daçiç, duke shtuar se komuniteti ndërkombëtar duhet të deklarojë nëse e do Serbinë si partner ose jo.

Serbia në dilemë për samitin e Sofjes, shkak Kosova

Beogradi po matet se në çfarë formati do të përfaqësohet në Samitin e Bashkimit Evropian - Ballkani Perëndimor, që do të mbahet më 17 maj në Sofje. Sipas gazetës serbe "Novosti", pas Spanjës edhe Rumania dhe Qiproja janë afër vendimit që të mos marrin pjesë në diskutimet kryesore në këtë takim. Këto tri vende anëtare të BE-së, që nuk e kanë njohur Kosovën shtet, nuk duan që të jenë në të njëjtën tryezë me përfaqësuesit e Prishtinës, madje as që të gjenden në fotografinë e përbashkët, e cila është e zakonshme për konferencat të tilla.

Bombë në oborrin e shtëpisë së gazetarit malazës

Në Bijelo Polje të Malit të Zi, mbremjen e së dielës ka shpërthyer një bombë në oborrin e shtëpisë së gazetarit të televizionit "Vijesti", Sead Sadiković. Lajmi bëhet i ditur nga Anadolu Agency, sipas të cilit nga shpërthimi nuk ka pasur viktima, pasi bomba ishte hedhur në vendin e parkimit të automjetit të gazetarit. Policia bën të ditur se mjeti shpërthyes është hedhur para shtëpisë së Sadikovićit. Në vendin e shpërthimit, nuk ka qenë i parkuar automjeti i gazetarit, por një automjet me targa të Beogradit, pronë e një agjencie automjetesh.

Zyberaj: Turqia mik i Kosovës, jemi të hapur për dialog

Presidenti turk kërcënoi Haradinajn, reagon zyrtari i MPJ: Mos u përzini në punët tona

Jetlir Zyberaj është zyrtari i parë i Ministrisë së Punëve të Jashtme që i ka reaguar deklaratave kërcënuese të Presidentit të Turqisë, Rexhep Taip Erdogan. Ai ka thënë se do të kërkojnë llogari nëpërmjet kanaleve diplomatike për deklaratat e presidentit turk. Duke reaguar për kërcënimin për rrëzimin e qeverisë, Zyberaj ka shkruar se Kosova nuk lejon asnjë shtet tjetër të përzihet në punët e brendshme të shtetit përfshirë edhe rrëzimin e kryeministrit. "Turqia është vend mik i Kosovës, vend që e ka mbështetur dhe e mbështet Kosovën në vazhdimësi. Nëpërmjet kanaleve diplomatike, në ditët në vijim, do të sqarojmë arsyet e deklaratave të bëra nga presidenti Erdogan, në pajtim me marrëdhëniet e mira që kemi si dy shtete dhe të parimeve të barazisë së shteteve sovranë dhe mospërzijerjes në punët e brendshme", - shkruan zyrtari i MPJ.

JETLIR ZYBERAJ

"Turqia është vend mik i Kosovës, vend që e ka mbështetur dhe e mbështet Kosovën në vazhdimësi. Nëpërmjet kanaleve diplomatike, në ditët në vijim, do të sqarojmë arsyet e deklaratave të bëra nga presidenti Erdogan, në pajtim me marrëdhëniet e mira që kemi si dy shtete dhe të parimeve të barazisë së shteteve sovranë dhe mospërzijerjes në punët e brendshme", - ka shkruar Zyberaj, shkruan Express. "Ne jemi të përkushtuar të kultivojmë marrëdhëniet ndërshitetore me të gjithë partnerët ndërkombëtarë dhe me Tur-

qinë mike. Dihet fare mirë se Kosova është e hapur për bashkëpunim dhe dialog me Turqinë në secilin fushë, pa pasur nevojë për interferim në punët e brendshme. Kosova ka institucionet e veta dhe ato udhëhiqen me përgjegjësi dhe respekt nga udhëheqësit e zgjedhur me votën e popullit", - ka shtuar ai. Reagimi i Zyberajit ka ardhur pas kërcënimeve

qinë mike. Dihet fare mirë se Kosova është e hapur për bashkëpunim dhe dialog me Turqinë në secilin fushë, pa pasur nevojë për interferim në punët e brendshme. Kosova ka institucionet e veta dhe ato udhëhiqen me përgjegjësi dhe respekt nga udhëheqësit e zgjedhur me votën e popullit", - ka shtuar ai. Reagimi i Zyberajit ka ardhur pas kërcënimeve



Zyrtari i parë i Ministrisë së Punëve të Jashtme, Jetlir Zyberaj

të Erdoganit drejtuar Ramush Haradinajt, pasi ky i fundit shkarkoi nga pozita e Ministrit Flamur Sefajin dhe Driton Gashin e AKI-së. Këta dy kishin marrë pjesë dhe ishin në dijeni për operacionin e inteligjencës turke në arrestimin e gjashtë gjylenistëve, të cilët pastaj u dëbuan në Turqi. Ndaj këtij kërcënimi ka reaguar edhe kryetari i parlamentit, i cili ka thënë se nuk u japin llogari asnjë shteti tjetër për veprimet e udhëheqësve. Deri tani, për këtë kërcënim, asnjë fjalë s'ë ka thënë Ramush Haradinaj dhe as presidenti Hashim Thaçi. Gjashtë

shtetasit turq u dëbuan nga Kosova me një vendim të Ministrisë së Punëve të Brendshme, e cila kishte revokuar lejet e qëndrimit në Kosovë. Revokimi kish-të ndodhur pasi AKI në bashkëpunim me inteligjencën turke kishin konstatuar se të njëjtit persona përbëjnë rrezik kombëtar për Shtetin. Sidoqoftë, operacioni për arrestimin dhe dërgimin e turqve në Turqi ishin zhvilluar gjatë ditës së enjte. Ishin deportuar për në shtetin turk me një procedurë të përsheptuar.

TEATRI

Fatmira Nikolli

Ka vijuar edhe dje e hëna e protestës për Teatrin Kombëtar. Aktorë, arkitektë e artistë janë mbledhur sërish kundër shembjes së godinës së TK dhe kundër projektit të prezantuar në mesmars. Prej fillimshkur-tit artistët nuk janë tërhequr nga qëndresa e tyre për çështjen, duke dalë kundër bashkisë, ministrisë dhe qeverisë. Kulmi ka arritur dje kur Robert Ndrenika njësoj si në letërnë e vitit 2002 i ka kërkuar kryeministrit Rama t'i lërë të qetë aktorët. Më poshtë fjalët e artistëve dje.

ROBERT NDRENIKA

Ky Teatër ishte çerdhja jonë, kopshti jonë, nuk kemi marrë ndonjë rrogë të madhe, e kemi shtyrë me talone e ... Por unë shoh që në një mendje jemi të gjithë. Ka mendime të ndryshme, por kundër asaj PPP-së, jemi të gjithë në një mendje. Ai donte të bënte një P, me një çiban në kokë priste më 97. Tani do të na nxjerrë ca çibanë, por jo këtu në kokë, por rreth e rrotull nëpër trup. Unë jam kundër PPP-së, jam u mendimit dhe kam qenë që teatri kombëtar, shtetëror duhet ta bëjë shteti, e ka për detyrë ta bëjë shteti. Në këtë drejtim i bëj thirrje edhe Presidentit të Republikës, të prononcohet në këtë pikë: duhet ta bëjë shteti Teatrin Kombëtar apo jo? Ndërsa PPP-ja po të ketë dëshirë le të bëjë teatro private sa të dojë. Tani ç'mendje kam? E kam parë këto ditë me vëmendje dhe këtë sallë, dhe Eksperimentalin. Kjo që u lye e u mirëmbajti sic e kemi thënë të gjithë, kjo rron. Por edhe për Kombëtarin që nuk është vënë asnjë gozhdë gjatë këtyre 27 vjetëve, unë ju siguroj dhe kjo mund të qëndrojë dhe 70 vjet të tjera, pa vënë asnjë gozhdë. Kam mendimin që ne të presim se edhe një vit apo dy, ne nuk e heqim dot, por ai do të largohet vetë dikur... Ai do të të PPP se s'ka nga shkon. Ne, të presim dhe pastaj të vazhdojmë punën këtu, dhe mbase kryeministri të PPP-jë, ne të vazhdojmë të bëjmë teatër, e të zgjedhim rruget tonë. Të paktën të na lërë të qetë.

VASJAN LAMI, AKTOR

Është kënaqësi që në këtë shqetësim tonin nuk po na lini vetëm, dhe arsyeja është madhore, sepse teatri është kombëtar, pra nuk është vetëm i yni. Do të dëshiroja që të kishte më shumë njerëz, veçmas aktorë, sepse kushdo ka përgjegjësi morale dhe artistike. Që qyteti të prononcohet, të thotë mendimin e tij: çfarë do të bëhet me teatrin? Ky teatër, e kanë thënë shumë mirë edhe arkitektët, se ka vlera historike. Ta shuash është shumë kollaj, ta ruash është po aq kollaj. Unë, si Vasiyan, jam që të ruhet. Ndërsa, teatrin e ri, le ta bëjnë diku tjetër, sepse është shumë mirë, që qyteti të ketë një teatër të ri. Por se di deri ku mund të shkojmë me këto mbledhje. Kam mendimin, që të bëjmë një referendum, edhe aty të marrim një vendim popullor.

ALERT ÇELOLIJAJ, AKTOR

Kjo është dëgjesa e katërt për Teatrin Kombëtar, e iniciuar nga Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Teatrit, që është kundër shembjes së TK. Tema e kësaj jave është: "E drejta qytetare në vendimmarrje". Këtë e bëjmë për sensibilizim, por edhe për të ditur se cilat do të jenë të drejtat tona në këtë nisim të hapur dhe jo ligjore. Gjëja që po vuajmë në këtë rast është transparencja! Nisma është nisur nga SPAK (Sindikata e Pavarur e Artistëve të Teatrit Kombëtar) dhe është mbështetur nga SASE (Sindikata e Artistëve të Skenës dhe Ekranit). Komisionari i të drejtës së informimit na ktheu një përgjigje që ishte se: "Tashmë, projekti është bërë publik". Projekti është bërë publik, por ne atje kemi parë vetëm rendera se si do të jetë TK. Më e rëndësishme është që rrenderat nuk janë një projekt. Vazhdojmë që të na shmangen, prandaj ka mungesë transparence, sepse ne nuk dimë asgjë se si do të jenë sallat, skena, gardëroba, ambientet ndihmëse në TK. Kjo hije mjegulle krijohet nga ata që kanë në dorë projektin edhe ja hedhin njërit-tjetrit si patate, njëherë e ka bashkia, njëherë ministria dhe njëherë kryeministria.

ARBEN DERHEMI, AKTOR

A e kuptoni, sesa e dhimbshme është që vjen një arkitekt dhe na thotë: Vrisni frikën! Neve, aktorëve të Teatrit Kombëtar, që sot jemi kaq pak këtu. Ndërkohë, këtu vijnë artistët Cirkut

ARTISTËT NË PROTESTË

Ndrenika për teatrin: Rama të na lërë të qetë

Arben Derhemi: Të vrasim frikën,
Vasjan Lami: Të ruhet godina



Kombëtar, të gjithë siç janë, për të mbrojtur territorin e Teatrit Kombëtar. Ndërsa, aktorët e Teatrit Kombëtar edhe aktorët e Teatrit Eksperimental, që duhet të ishin të gjithë këtu sot, për të mbrojtur punën e tyre, dinjitetin dhe personalitetin e tyre karshi një njeriu që po na ç'ben, karshi një arroganti, që nuk i lindi dëshira për të bërë Teatrin e ri, por i lindi dëshira për të bërë pesë-gjashtë-shtat kulla, prandaj erdhi fati i teatrit, që po s'bëhet. Ky njeri nuk kishte ndërmend që të bënte TK. A e kuptoni këtë? Madje, dëshiron që ta zhdukë edhe këtë që është. Të vrasim frikën? Si vritet frika? Të hënë tjetër, ç'di kush nga ne të sjellë edhe 10 apo 50 vetë, edhe do ta vrasim frikën brenda vetes njëherë. Në rast se kemi bërë ndonjë gabim, në rast se kemi mbjellë ndonjë pemë ndonjëherë. Unë, jo! As kam ndërmend që të mbjell. Nëse kemi marrë një lekë gabimisht edhe kemi bërë një biznes gabimisht me këta njerëz, në rast se u kemi thënë frikën gabimisht, duhet që të vrasim frikën me një kartarsis brenda vetes sonë. Edhe duhet që të japim fjalën, se nuk bëhet m. Nuk bëhet më në këtë mënyrë! Nuk flitet më me këta njerëz, sepse këta janë një ruspë e madhe, që nuk duan të dinë fare për shpirtin. A e kuptoni, që ai njeri nuk ka shpirt, pasi themeli i shpirtit është familja. Besoj se e kuptoni!

BASHKIM ZAHAJ, SKENOGRAF

Mendoj që lëvizja jonë duhet të bëhet në një mjedis të mbyllur, dhe kjo është një e drejtë e Sindikatës dhe nga një kontratë e përbashkët që është aprovuar shumë kohë përpara, dhe institucionet duhet ta respektojnë dhe e kanë detyrim ligjor. Nëse nuk marrim dot një sallë për t'u mbledhur mendoni se sa mund të marrim gjëra të tjera. Mendoj se duhet të bëjë një CD që të jetë me xhirime më interesante që janë në arkiv në RTSH me personalitete shumë të shquara, që nuk janë sot midis nesh, ose dhe janë, çfarë kanë thënë për teatrin. Janë xhirime shumë interesante, dhe kjo CD të shpërndahet nëpër institucione, dhe të shfaqet në mbrëmje nga teatri eksperimental për të luajtur në rol tek të rinjtë që nuk e njohin. Duhet të thirren edhe studentët e arkitekturës dhe të arteve. Ne kemi studentë të arkitekturës të jashtëzakonshëm.

Po ashtu duhet të bëhet një bisedë me presidentin nga një grup prej artistëve, për të marrë një mendim prej tij. Dhe e fundit është e pamundur që lëvizje të tilla të mbajnë larg partitë, mendimin opozitar politik. Në të gjithë botën lëvizjet patjetër partitë opozitare janë mbështetëse. Ky është mendimi im personal, dhe nuk e var xhakët në asnjë parti.

ELVIS HOXHA, PEDAGOG

Unë e kam jetuar këtë teatër, dhe pse ai është më i vjetër se unë. Kemi një fat të keq këtu se institucionet jetojnë më pak se njerëzit. Sot më vjen keq, Teatri ka lindur para meje, por shumë institucione që kanë lindur pas meje faktikisht do zhduken para meje. Nuk ka gjë më të hidhur: E dyta, që me vjen tmerrsisht keq është ky lloj kodi që kemi ne, në mendim. Ne kemi një fat shumë të madh sepse kemi pas një kryeministër mjek, dhe një piktor. Ai i pari vrau më 21 janar njerëz, edhe pse si mjek ka betimin e Hipokratit, për të shpëtuar njerëz, pikërisht ai ka shkelur hapur betimin e disiplinës së tij të mjeksisë. Ky kryeminis-

tri i tanishëm, që i thotë vetes artist që ka shkelur gjithë kodet e artit, sepse gjatë kohës së tij me mirëmbajtjen e tij, është vrarë kinema republika, 17 Nëntori, stadiumi... janë vrarë gjithë vendet e artit, kanë përfunduar nën kulla. Akademia e Artit, Teatri i Operës kanë qenë dhuratë për rusëve kjo do të thotë se gjithë perandoritë na kanë lënë një trashëgimi, dhe njëherë që ne, ndërtojmë shtet për t'i zhdukur gjithë këto gjurmë. Këta janë vrasës serial-kill-er, dhe më i madh serial killer është Ministria e Kulturës që vrau ish-godinën e Lidhjes së Shkrimtarëve, dhe tani shkoi të vriste Kinostudion. I prodhojmë këta. T'i akuzosh këta dhe të thuash se mungon frika, por më shumë se frika këtu mungon dashuria. Unë s'kam vend të flas këtu. Këtu duhet të ishin aq shumë artistë. Vetë ata duhet të flisnin, sepse kanë jetuar me djersë. Ne nuk jetojmë me emrat e personazheve tanë. Emri im është i vdekshëm. Këta aktorë kanë jetuar me emrat e personazheve. Nëse ka aritje Shqipëria, është vetëm vënia në skenë e një pjese të Evropës. Në vend që të shtonte sipërfaqen, kryeministri thotë a ka mundësi t'ua vras teatrin. Sa do të vrasin akoma? Sepse këtu po vrasin talentet e njeriut. Kjo është të presësh të gjithë talentet që ka njeriu. T'ia vrasësh aktrimin dramaturgjinë, talentin e shkrimit, muzikën, kërcimin... çfarë do të bëhet ky njeri veçse skllav? Këta janë vrasës të një cilësie të veçantë. Këta janë prodhues të skllavërisë, e një teknologjie të rreme, që gënjën shqiptarin, sepse do lodrat, ndonjë Benz Mercedes, nuk i do personazhet historikë, por kullat i do, vetëm të shesë. Ne po jetojmë tragjedinë e artit. Tragjedia ka lindur për ta hequr nga rruga. Ta lexojmë dhimbjen e tragjedisë. E futëm tragjedinë në skenë që të mos prodhojë e keqja mes njerëzimit. Ne po e nxjerrim prap nga skena po e fusim në popull. Ne nuk bëjmë pyetjen përse vriten kaq shumë shqiptarët mes tyre? Po, vriten, sepse ne nuk e shohim tragjedinë në skenë. Ne e rivalizojmë teatrin si disiplinë e 'Big brother', 'Portokollit', 'Al bazar' dhe ashtu siç bëjmë me pronën publike që e lejojmë ta shkatërronjë, e më pas thonë se shteti nuk e mban dot. Sikur ta mbanin Teatrin gjallë përpara se të vdisnin artistët e mëdhenj, të paktën ata mos ta shohin se si rrënohet jeta e tyre. Të paktën këta të gjojë që prodhuan një ndjenjë ç'kusur kanë...?!

BESNIK ALIAJ, ARKITEKT

Jo vetëm për artistët që kanë punuar, kanë jetuar në këtë ndërtesë, por edhe për ne që jemi qytetarët e Tiranës, ky mjedis do të thotë shumë. Unë jam i brezit që ka mbaruar shkollën

në 90-ën e them këtë për të theksuar se kam përjetuar një proces ndryshimi e transformimi të madh dhe një revoltë popullore ndaj shtypjes, po e quaj, vënies së shqellimit në fyt, jo se sot jemi në një situatë të njëjtë, por jemi gjithsesi në një situatë regjimi autoritar. Ajo që dua të ndaj me ju është një emocion që kam përjetuar në fillim të vitit 91 dhe ata që e kanë përjetuar, e dinë shumë mirë se për çfarë po flas. Kam qenë në një sallë të TK për të parë një shfaqje të jashtëzakonshme, për herë të parë kthehej Edi Luarasi pas një debimi artistik, artist të pranishëm këtu kanë qenë prezent. Ishte rikthimi i "zonjës plakë", ka qenë një nga ato moment që të rrëqethë mishi nga emocionet, prej fjalëve që artistët thanë së bashku, e që unë skam për ta harruar. Ishte një mesazh i jashtëzakonshëm për publikun, për të bërë ndryshimin e madh që pritje. E solla këtë moment, se të tilla çaste ka pasur shumë në këtë ndërtesë. Pikërisht në këtë ndërtesë që mund t'ju duket e zakonshme në pamje të parë, por që unë ju siguroj se është e jashtëzakonshme. E konfirmoj këtë, edhe si arkitekt, i përket një rryme që bota ka hyrë në modernizëm, racionalizëm, një rryme të veçantë për të cilin vendi ynë ka shumë nevojë, pasi gjithmonë ka shkuar pas stilit rrokoko, apo të dekoracioneve që, në fakt, thonë shumë për karakterin tonë. Nuk thonë atë që ne duhet të jemi të drejtpërdrejtë, të përballem me gjërat. Por unë besoj edhe duke përkrahur emocionin që solla, në atë që quhet shpirti i qytetit, shpirti i hapësirës publike, ajo është një gjë që nuk mund të blihet, nuk ka PPP që mund ta zëvendësojë atë. Ti mund të bësh xham, hekur, mund të bësh arkitekturën më moderne, por ajo nuk ka vlerë përbalë shpirtit, i cili është në eter, nuk mundet që ta zëvendësojë me material, me lekë dhe në forma të tilla. Pra, unë dua të them që kjo histori e jashtëzakonshme duhet mbrojtur, duhet ruajtur. Absolutisht që duhet investuar për ta mirëmbajtur sepse është është gjendja e tillë, kjo vjen nga që nuk është investuar. Në historinë e qytetit ne kemi pasur edhe histori të tjera "spastrimi", dhe ky qytet si të gjitha vendet e rëndësishme të Evropës Lindore ka kaluar dy moment të rëndësishme spastrimi, atë gjatë ekonomisë së centralizuar të ashtuquajtur komunizmit, se ne, në fakt, nuk e dinim se çfarë ishte, dhe moment tjetër është ai i ekonomisë së tregut që, gjithashtu, nuk e dimë se çfarë është. Është një dhunë që ushrohet dhe ndaj trashëgimisë ndaj kulturës, ndaj historisë, në mënyrë të qëllimshme dhe gjithçka matet vetëm me metër katrorë, me euro për metër katrorë, me vlerë monetare dhe material dhe asgjë tjetër nuk vlen. Shpirti nuk vlen! Në këtë aspekt doja të nënvizoja pikërisht këtë gjë që nesër kështu siç ka nisur kjo histori rrezikohet. Nisi me atë që quhet "Pazari i vjetër" i Tiranës, ndërkohë që ne sot mund të kishim një thesar me të cilin mund të bënim turizëm, do të kishim trashëgiminë, do t'ua tregojmë mysafirëve që vijnë, brezave të rinj. Do u tregojmë pastaj këto ndërtesa, do tregojmë dhe ne atë çka do mund të lëmë më pas e me radhë. Po ne sot s'kemi çfarë t'u tregojmë! Përse ne nuk kemi, ndryshe nga Greqia, Italia apo edhe fqinjët tanë sllavë, përse ne nuk jemi si të tjerët. Sepse ne historikisht kemi shkatërruar "shpirtin" e qytetit, e hapësirës publike, të kombit dhe kjo bëhet në mënyrë sistematike nga të gjithë pa përjashtim. Ndërkohë që duhet shumë pak dhe ajo që duhet është dashuria për vendin, për qytetin, asgjë tjetër. Mungon dashuria për vendin, nuk ka nevojë që patriotizmin ta tregojmë në fjalë të mëdha.

STUDIMI



Triumfi i flamurit kuq e zi pas një "Kryqëzimi" të vitit 1501

Nga Artan Shkreli

Prej vitesh qarkullon në rrjetet sociale shqiptare një pikturë e Rindjes Italiane me skenën e kryqëzimit të Krishtit e cila sot ndodhet në pinakotekën "Brera" të Milanos që prej vitit 1811. Bëhet fjalë për kompozimin me temë fetare "Crocifissione" të Michele di Zenones, njohur më së shumti si Michele di Verona, prej qytetit në të cilin ai veproi thuajse gjithë jetën e tij artistike.

Kjo pikturë ka bërë përshtypje për shkak të flamurit kuq e zi, por nuk ka mundur të hapë diskutime të mëtejshme për të sqaruar disi rrethanën e atij flamuri.

Kuadri në fjalë, është realizuar rreth vitit 1500, pra në kapërcyell të Rilindjes së Hershme, i destinuar për t'u vendosur në manastirin e Shën Gjergjit në Braida të Veronës, ku do të qëndronte i patruar dhe thuhet se panjohur, deri me ardhjen e furtunës bonapartiste në Itali. Bëhet fjalë për një telajo gjigante, në vaj mbi kanavacë, me dimensione 3.35 m lartësi dhe 7.20 m gjatësi. Trajtimi kompozicional është i tipit narrativ, i mbështetur në unigjijtë, me Jezusin e kryqëzuar në qendër dhe dy keqbërësit në krahët e tij. Në të majtë, veç tjerash, paraqiten legjionarë romake që luajnë me zare mantelin e Krishtit, një flamurmbytës me shpatë (që sugjeron vetë autorin), në këmbë të kryqit Shën Mëria në vajtim, e më tej, hierarkë hebrenj e ushtarakë romake, pjesëmarrës në aktin fatal.

Pa hyrë në origjinën dhe analizën e veprës, e cila është komentuar shterueshëm nga kritikët, tërheqim vëmendjen stemat dhe flamujt e shumtë që dekorojnë pikturën.

Në dy shtylla kompozicionale, anash telajos, kemi të bëjmë djathtas me stemën e Niccolò Orsini, kont i Pittiglianos dhe majtas me atë të së shoqes Elena Conti di Segni (i lidhur në martesë me 1467), ndërsa lart valojnë dy flamuj me shujka (stema) të mirëpërcaktuara. Ato mbahen nga "gonfaloniere" respektivë, por me paraqitje të ndryshme. Flamuri në të djathtë i përket Romes, pra perandorisë, (shquhet akronimi i famshëm romak SPQR), me një shirit të bardhë ku figuron simbolikisht një gaforë.



Disa të dhëna e studime mbi veprën e Michele da Verona, që shfaq flamurin e Gjergj Kastriotit

Çka bie në sy është fakti se autori nuk bën përpjekje për t'i paraqitur personazhet e tij me veshjet e antikitetit, por propozon ato të kohës së vet. Domethënë stili i kostumeve, flokëve apo armëve është i periudhës së Rilindjes Italiane me qëllim aktualizimin e skenografisë së famshme për ta sjelle atë në prag të kohës së re. E ndërsa kalorësi i djathtë është veshur alla-italiana, në modën e Rinascimento, flamurmbytësi në të majtë, që mban një flamur kuq e zi, ka një paraqitje alla-levantina.

Shujka në flamur dëfton një shqiponje të zezë dykrenore në fushë të kuqe, gjë që përbën interes për ikonografinë albanologjike. Pytyrimi i shqiponjës heraldike, këtu i përmbahet më së shumti traditës mesjetare, duke e paraqitur atë si sikurse shfaqet në portulanet italiane e majorkane të Treqindtës, domethënë me krahë të ulur, por ndërkaq ndjehet edhe ndikimi mitteleuropian, pasi sqepi e kthetrat nuk janë njësh të zinj por të artë.

Mbi krerët e saj, ne mes, qëndron një kurorë e vogël e praruar, simbol ruajal. Ndërsa flamurit bazë i bashkangjitet në pjesën e sipërme një shirit i artë i gjate me tri elemente të ngjashëm me "fleur de lis" karakteristike për shtëpinë e vjetër anzhu e cila për një kohë të gjatë ka mëtur bashkimin dinastik midis mbretërëve në dy krahët e Adriatikut.

Michele da Verona, i financuar në këtë veper nga çifti aristokratik në fjalë, shënon vitin e veprës "MCCCCCI die II luni" (2 qershor 1501), kur Orsini prej gjashtë vjetësh shërbente pranë Serenissimas si ushtarak i lartë (kish qenë më parë feldmarshall i Republikës së Firences e më pas Kapiten i Përgjithshëm i Kishës nen papatin). Do theksuar se pikërisht kjo periudhë përkon me kohën kur kujtimi dhe bëmat e Skënderbeut njihin një përndejeje të jashtëzakonshme në botën italiane, e në mënyrë të veçantë në Venedik, i cili gjendej më tepër se kurrë në

ballë të luftës e i kërcënuar nga osmanët. Veç territoreve të tjera në Lindje, sa i takon Arbënisë, ajo kish humbur 20 vjet më parë Krujën e Shkodrën, e po detyrohej të linte këtë vit të fundit posedime jugore të Albania Venetas (me braktisjen e qytetit të Durrësit dhe të kështjellës së Rodonit), për t'u kufizuar vetëm në traktin Ulqin-Kotorr.

Pa dyshim që Orsini kish pasur kontakt me arbrit e Gjergj Kastriotit kur ai kish shërbyer për një dekadë të tërë si "condottiere" në Mbretërinë e Napolit më 1463-shin; kështu që kjo ringjallje e vrullshme me natyrë ideologjike e figurës së Skënderbeut, komandantit të madh thuhet kohanik me të, nuk e ka lënë indiferent. Kasta të cilës Orsini i përkiste kish nevojë për një mit të pathyeshëm, për një simbol bashkëkohor që mundte të keqen edhe kur dukej se ajo kish triumfuar. Sekush sponsorizonte në mënyrën e tij këtë gjë; dikush përmes ndihmës konkrete në sh-

tarë e armatim, dikush përmes ndërmarrjes së botimeve të librave me histori evokuese e dikush përmes përjetësimit në vepra artistike skulpturore, piktoreske e deri muzikore. Duket sikur një komision i posaçëm komisiononte, redaktonte dhe mbikëqyrte ndërtimin e mitit. Në këtë frymë shihen mjaft punë të Rilindjes italiane kryesisht në mjediset e kontrolluara nga Serenissima dhe Papati; në këtë frymë shihen edhe zbulimet e vogla por të rëndësishme të zonjës Lucia Nadin botuar së fundmi; në këtë frymë është komisionuar edhe kjo veper mbresëlënëse nga ana e mecenatëve të sipërpërmendur. Kështu, flamujt e Lindjes dhe Perëndimit, armët ballkanike e italiane, përfshirë veshjet dhe manierat, asistojnë në këtë kompozim tragjik agoninë e një qytetërimi të sakrifikuar, me shpresën e ringjalljes pas kryqëzimit si shprehje e një vullneti hyjnor. Piktori nuk kursen detaje të kohës sikurse burri me çallmë turke në plan të parë, apo elemente me qasje etnike që ndërmendin stratiotët arbër - sikurse kalorësi që shihet në të djathtë (në plan të dytë) i pikturuar kujdesshëm me kësulën e tij të zezë, aq e njohur në Evropë si "chapeau albanoise".

Pare kësisoj, duhet konsideruar se te vepra "Crocifissione" nga Michele da Verona, kemi trashëgatur të parën paraqitje piktoreske, ku shfaqet simbolikisht dhe me vendosmëri vizive flamuri i Gjergj Kastriotit, flamur që të pak-tën prej tri dekadash i kish kapërcyer kufijtë e provincës arbërore dhe ish shndërruar në simbol rezistence e force ndaj së keqes.

Për rëndësinë që paraqet, në vepra do ish porositor në kohën e Karlit V, fare mirë kritikët do kishin rëndur për ta konsideruar një flamur të tij, sikurse janë rrekur të paraqesin atë që studiuja Nadin ka shquar në kishën e Shën Sebastianit në Venecia, por kjo është e pamundur, pasi piktura është kryer kur Karli V's kish bërë ende një vjeç.

Opinion i Ditës

Kompleksimi pervers i një proteste qytetare

Nga Mimoza Koçiu

(Vizion nga faja e parë)

... më 31 mars reagan kundër tarifës në Rrugën e Kombit, pa prit që ndonjë parti t'u printe, a t'u përcaktonte arsyen e protestës. Që qytetarë të ngrihen kundër një vendimi qeveritar, që i dëmton ekonomikisht, kjo është një praktikë që raportohet rëndom në çdo vend demokratik, fatkeqësisht tejet e rrallë në Shqipëri. Përkishtë si e tillë, ajo ia doli të tronditë sigurinë e pushtetit të një kryeministri që pretendonte se "Kjo e ngritjes është 'thirri, thirri të të ngrihet, ai i shkreti kokullor s'të përgjigjet dot". Ngritja ndodhi, e pa një parti nga pas për ta anatemuar, edhe pse kryeministri u rrek jo pak t'ia futuronte opozitës, meqenëse bashkia e Kukësit administrohet nga të djathtët. Ai reagim qytetar u amplifikua përmes mediave e rrjetëve sociale, si një akt i harruar i shqiptarëve, që rëndin veç kur i thërrasin partitë, në të kundërt, protestat i zhvendosin në 'Facebook'.

Kompleksimi që po tentohet t'i bëhet asaj proteste, duke e lexuar si reagim të dhunshëm ndaj modelit të tarifimit të rrugëve, që ndiqet në shumë vende të botës, është më së paku, shenjë e mosreflektimit cinik e djallëzor, të kujt e provokoi atë lloj reagimi, por edhe mercenarizëm i ulët, fatkeqësisht edhe nga njerëz të medias, për t'i bërë jehonë qorrazi, a për interesa krejt të ngushta, hallit të kryeministrit.

Se si mund të justifikohet një tarifë 10 euro vajtje-ardhje, për një banor të zonës, që duhet të kalojë jo vetëm në Kosovë, por thjesht në fshatin përtej, brenda kufirit, ku ka të afërm a një vend pune, apo që do të udhëtojë drejt kryeqytetit, pa një studim të mundësive financiare, pa e konsultuar, pa e informuar, e pa i mundësuar një aks alternativ rrugor pa pagesë, siç është modeli i vendeve, ku aplikohet tarifimi i rrugëve për mirëmbajtje, këtë mund ta dijë vetëm ky kryeministër dhe kushdo tjetër, që po rropatet t'i rregullojë frymëmarrjen, duke recituar avazin e tij, për vandalizëm të asaj proteste.

Ai unifikim kuksian, i demokratëve që nuk e duan Edi Ramën, me socialistët që e përfaqësojnë atë në këshillin bashkiak, ishte realiteti kokëfortë që la pa frymë kryeministrin, që ishte kundër shpërfilljes që u bëri banorëve të asaj zone, pa dallim. Ai gjest i rrallë bashkiak, që bëjnë sikur nuk e shohin mercenarët kryeministrorë, spikati edhe më fort, kur i pari i qeverisë i bëri lanet dhe i përjashtoi nga partia, në transmetim të drejtpërdrejt televiziv këshilltarët e vet në Kukës, vetëm se ata, njëlljosi si të djathtët, refuzuan të konsideroheshin shifra për të mbushur gropat e asaj rruge, nga një kryeministër për të cilin kanë mbledhur vota në Kukës, e që nuk i logarit si banorë të një zone të varfër, por

u vuri në kurriz, pa e menduar hiç, një barrë jo të lehtë financiare për ta.

Ata banorë, të majtë e të djathtë kishin një javë që ankoreshin në rrugë e rrjete sociale, por askush nuk ua vuri veshin, deri kur u ngritën vetë, për ta derdhur gjithë zhgënjimin për shpërfilljen, fatkeqësisht ndaj investimit privat, i vendosur në kufi, sipas kontratës ligjore me qeverinë.

Në fakt, pa atë reagim, Edi Rama

kryeministri i kupton. E parashikuar është që kuksianët duhet të paguajnë nga 5 euro një kalim, në 60 ditë e para të hyrjes në fuqi të tarifës, kohë që kryeministrin iu dashka për të kuptuar, se sa prej tyre nuk duhet ta paguajnë atë.

Ky është një shpërdorim krejt i pastër i forcës së pushtetit, që qytetarët i kanë dhënë, edhe pse asgjë e paparë akoma. Politika arrogante e faktit të kryer është një tipar që e ka shoqëruar këtë kryem-

zione, ku ndihma ekonomike shkon nga 2300, në 6700 lekë të reja.

Ky është "vizioni" që e vulos pa pyetur kryeministri në realitetin e Kukësit. Një kryeministër aq "vizionar", që nuk e dallon se profesionistët po i largohen sistematikisht këtij vendi, e këtu po mbeten e shtohen "të fortët", ata që gjejnë strehë në këtë lloj politike, ata që sigurojnë vota për të mbajtur e ushtruar pushtet, e jo për të ndërtuar shtet për qyteta-



do vazhdonte rehat turin fushatues për të siguruar votat për zgjedhjet e ardhshme vendore, me audienca të përgatitura qytetarësh, që e duartrokasin pa kushte, bash si në Vlorë, kur i njoftoi se së shpejti do paguajnë tarifë, edhe për rrugë të tjera brenda vendit.

Pa atë protestë, kryeministri nuk do dilte dy ditë radhazi në media, për të tentuar të bënte çka nuk i kishte kaluar ndër mend, informimin e qytetarëve mbi atë tarifë, e duke rrëfyer përmes justifikimeve publike, se nuk e kishte konsideruar situatën e banorëve të asaj zone, para vendosjes së asaj tarifë.

Çka ka menduar si zgjidhje, duket një tjetër taktikë për të mos i konsideruar kuksianët. Se si mund të ndahen banorët e asaj zone, në përdorues të shpeshtë a të rrallë të rrugës me pagesë, apo pa akoma më tej, me cilin kriter matës do provohet se janë përdorues të shpeshtë të asaj rruge, kjo duket nga ato idetë vizionare, që veç

instistër, që ditën e parë që është ulur në atë karrige. Nuk është hera e parë që me mungesë konsiderate e shpërfillje, i detyron qytetarët të dalin në protestë dhe çdo herë, u reciton në transmetim të drejtpërdrejt televiziv, skriptin viktimizues të të pakuptuarit të madh, e të sakrifikuarit misionar në politikë.

Kryeministri e identifikon drejt faktin se për këto tarifa nuk ka reaguuar njeri prej 14 muajsh, kur ato janë miratuar e bërë të ditura nga mediat. Por e njëjta logjikë vlen edhe për vetë kryeministrin, që po për 14 muaj, nuk e ka konsideruar mundësinë që, më mirë vonë se kurrë, ta studionte situatën e nevojat e banorëve të Kukësit.

Ndaj është e mjerueshme që e drejta demokratike për protestë krejt qytetare, ndaj shpërfilljes e arbitraritetit, të paraqitet si "injorancë" ndaj tarifimit të një rruge, pa rrugëzgjidhje: ose paguaj 5 euro një kalim, ose izolohu aty ku je, se rrugë alternative pa pagesë nuk ka! Kjo tarifë vjen për banorë e një

rët. Me këtë "vizion" është krejt e natyrshme, që emigrimi i trurit justifikohet si kërkim mundësisht të reja, ndërsa halli i pjesës tjetër të qytetarëve, si ai i banorëve të Kukësit, duket i pavend, madje një kapricio që synon të "sabotojë" ndërtimin e Shqipërisë që duam. Por vjen një moment, kur qytetarët vendosin të ngrihen përkundër pritshmërive të një kryeministri, e pa një parti nga pas. Në atë formë ata shkaktojnë panik, që reflektohen me terror policor në errësirë, por edhe solidaritet të gjerë qytetar. Pavarësisht numrave të dukshëm në Kukës a Tiranë. Solidarizimi me banorët e Kukësit nuk është refuzim për të paguar tarifa rrugore, siç djallëzisht paraqitet. Është reagim ndaj qeverisjes arrogante, që prioritet ka rritjen e barrës fiskale, jo mirëmenaxhimin e taksave që mbledh. Është shenjë se politika shpërfillëse "hajt se folim", nuk mund të ngjisë më, e se qytetarët merren në konsideratë vetëm kur ngrihen në protestë.

HOROSKOPI

DASHI

Hëna do të ndezë midis jush dhe partnerit zjarrin e sedrës dhe të xhelozisë. Thojni po dialogut dhe arsyetimit për të zgjidhur problemet. Mos i mbrori miqtë edhe kur nuk kanë të drejtë. Jini më të ekuilibruar në justifikime.

DEMI

Marsi në qiellin tuaj është i gatshëm të dëgjojë zërin e Hënës. Do të pranoni mundësinë e një pune të papritur dhe shumë të dëshiruar. Me Uranin dhe Saturnin kundra mund të vini në pikëpyetje disa zgjedhje. Vazhdoni përpara!

BINJAKET

Me Plutonin kundra, nëse mbani inat ndaj dikujt apo diçkaje, do të jetë më e zgjuar dhe e fryshme të përballeni me problemet dhe t'i tejkaloni. Bëni një zgjedhje të saktë me personat me të cilët rini: jo të gjithë ju ndihmojnë të vlerësoni cilësitë e juaja.

GAFORJA

Me Hënën dhe Mërkurin që ju mbështet, do të nxiteni nga kureshtje të reja. Do të keni mundësinë të keni frymëzim për të shprehur idetë. Do t'i largoheni atyre që u japin më shumë rëndësi gjërave sipërfaqësore, duke zgjedhur pasurinë e karakterit.

LUANI

Kundërshtimi i Uranit i bën disa vendime të vështira. Prandaj, nuk ju ngelet gjë tjetër, përveçse të angazhoheni! Tregohuni të vëmendshëm ndaj kritikave të një miku, për të kuptuar se çfarë përshqypjes kanë të tjerët për ju.

VIRGJERESHA

Për meritë të Marsit dhe Uranit që i buzëqeshin Hënës tek shenja e juaj, sot marrëdhëniet tuaja do të jenë më të fuqishme. Mund të ndryshoni mendje për një eveniment. Do të keni takime të mrekullueshme që do t'ju ndryshojnë jetën e dashurisë apo do të forcojnë lidhjet ekzistuese.

PESHORJA

Për shkak të veprimtarisë së Hënës, ritmet e ditës do të bëhen të paqëndrueshëm. Do të jetoni momente kënaqësie, por edhe çaste pasigurie. Mos e shmangni afirmimin e një personi që keni njohur së fundmi, mund t'ju bëjë kureshtarë me shumë sеса mendoni.

AKREPI

Me Hënë që ju favorizon, nëse jeni beqar, diskut do t'ju afrohet me ndjenja të sinqërta, po ngadhënjimi nuk do të jetë i lehtë. Do të pretendoni gjithmonë shumë. Në horizont shquhen mundësi të mira profesionale, që duhen shfrytëzuar menjëherë. Mos i lini t'ju ikin.

SHIGJETARI

Për ta pasur të qetë jetën në çift, është e udhës që t'i përshatani kërkesave të ndryshme të partnerit dhe të jetës. Dorëzohuni përpara fakteve. Me Neptunin dashamirës, përkushtojuni një kauze të rëndësishme. Jini të gatshëm t'ju jeni atyre që nuk kanë.

BRICJAPI

Nëse jeni në kërkim të një pune, me Jupiterin që ju ndihmon, bëni gjithçka mundni për të goditur në shenjë. Do t'ia dini, padyshim! Jini më altruist. Jepini prova të bujansisë suaj, duke ndihmuar atë që kanë më nevojë për ju.

UJORI

Për meritë të Neptunit në qiellin tuaj, do të dini si të dini nga situata e përditshme falë një intuitë të pagabueshme. Do t'ju propozojnë t'ju përkushtoheni personave në nevojë apo të bëni bamirësi.

PESHQIT

Marsi dhe Venusi do të bëhen bashkë për të bërë që të kaloni kohën në shoqëri të mirë. Do të merrni më të mirën e asaj që ju rrethon. Nëse duhet të dilni të filsi para njerëzve, do të jeni shumë të favorizuar nga një shprehje e qartë dhe e saktë.

Opinion i Ditës

"Chatbots"- drejt një marrëdhënie mes palësh me audiencat


Nga MONIKA STAFIA

(Vijon nga faqja e parë)

... të Amerikës, filloi të eksperimentojë mbi chatbots në vitin 2016, lexuesit u shfaqën të ngazëllyer... dhe në të njëjtën kohë sigurisht edhe pak konfuzë. Ata u mahnitën nga teknologjia e re, megjithëse më të shumtët teksa e përdornin, nuk kuptonin se kush ishte në anën tjetër të komunikimit online. "Shumë përdorues të tij me sa duket mendonin se po komunikojnë me një person tjetër," shpjegonte një prej menaxherëve të kësaj gazete, e cila kish ndihmuar të testohet së pari ky eksperiment komunikimi tek prindërit vendas dhe tek një grup tjetër që veçonte super blerësit e vendit.

Bots- këto programe kompjuterike gjenden kudo tani; në më të shumtën e rasteve ato ndihmojnë njerëzit të përdorin Lyfts (rrjet ndërkombëtar transporti), të porosisin pica apo të zgjedhin artikuj të ndryshëm - dhe prej praktikës kemi mësuar përvoja nga më të ndryshmet, që nga më e thjeshta dhe e lehta në përdorim deri tek trulllosja apo e pakëndshmeja që ato mund të shkaktojnë. Sidoqoftë, aksionet mbeten më të larta, për ato programe kompjuterike që i përkasin agjencive që e cilësojnë veten si burime të besueshme informacioni. Por, çfarë ndodh në të vërtetë? Audiencat ç'orientuese dhe dezinformuese, qoftë dhe aksidentalisht apo vetëm për një moment, mund ta dëmtojnë besueshmërinë e një redaksie. Kjo sigurisht nuk do të thotë që gazetarët nuk duhet të përdorin këto programe kompjuterike (bots), por ata duhet t'i kushtojnë vëmendje të posaçme mënyrës se si ata i paraqiten lexuesit. Ky ishte shkaku që një eksperte e përmbajtjes së këtyre programeve kompjuterike, Jennifer Hefty, e peshoi mirë kur vendosi ta lançonte këtë program, redaksisë së saj disa javë para zgjedhjeve të vitit 2016.

Hefty, e cilësuar si një strategje e përmbajtjes, pat marrë pjesë në një seancë mbi gazetarinë bashkëbiseduese, gazetarinë e së ardhmes në një konferencë mbi lajmet online. Ajo kish shfaqur dëshirën të testonte eksperimentin e saj, por ishte, gjithashtu, e vetëdijshme mbi potencialin e teknologjisë për të mashtruar. Për të mbajtur lexuesit të informuar rreth këtij testi, ajo krijoi një video mësimore dhe një tutorial të shkruar për të prezantuar "Elexi", një program në Facebook Messenger për t'iu përgjigjur pyetjeve rreth kandidatëve dhe për të dhënë rezultate natën e zgjedhjeve. Udhëzuesi përshinte hap pas hapi mësim për përdoruesit, informacionet e kontaktit mbi të dhe, në kuadrin e fundit në video, një pohim të rëndësishëm: "Mos harroni, unë jam një robot, jo një njeri". Gjatë kohës që ky program ishte live, Hefty e mbikëqyrte atë nga afër, duke bërë korrigjime të vazhdueshme për t'i ruajtur përdoruesit nga tensioni dhe hutesa e momentit. Vazhdimisht ne flasim kaq shumë për transparencën, për mënyrën se si ne i bëjmë gjërat dhe pse i bëjmë ato. Ndaj është rreptësisht e nevojshme që njerëzit të



mund të kontribuojnë cilësisht me besueshmërinë e tyre kur në këto programe ka diçka që nuk shkon e madje të dinë se pas këtij komunikimi virtual ka një person të vërtetë.

Kjo lloj mbikëqyrje e ndërsjellët mes palëve, ti këndej dhe atij andej, në anën tjetër të programit, është vendimtare për të parandaluar problemet dhe për të ruajtur besueshmërinë, shpjegojnë ekspertët perëndimorë të botës së medias. Kjo mënyrë i ndihmon redaksitë e lajmeve në televizion dhe radio të bashkëveprojnë me audiencën e tyre në mënyrë më efektive. Në rastet kur chatbots përdoren vetëm për shpërndarje produktesh apo marketing, nuk është e nevojshme një përfshirje njerëzore. Sigurisht që është një rrugë për të tërhequr klientelë, por, nëse ato përdoren për angazhim social, përkushtim njerëzor dhe profesional, atëherë ato vihen gjithmonë e më shumë në shërbim qytetarëve të zakonshëm; përndryshe, shërbimi që ju ofroni nuk do të jetë aspak i sigurtë. Transparenca në të tilla komunikime është lajtmotivi i këtij projekti në çdo subjekt a institucion publik apo privat që mund të aplikohet edhe

/// EKSPERTËT

'Si mund ta bëjmë këtë program që secili në anën tjetër, të ndihet se po i shkruan një miku?' Është fare e thjeshtë, përgjigjen po ata. Për sa kohë që jeni të hapur dhe transparentë në atë që po bëni dhe me kë po flisni... asgjë nuk ju pengon të krijoni një marrëdhënie autentike me tjetrin, edhe kur në mes është diçka që ngjan si artificiale.

në Shqipëri. Ata që e kanë ideuar dhe projektuar atë sigurisht kanë menduar ta sjellin shumë më të thjeshtë dhe akoma më të lehtë për ta përdorur. Mendjet që e ideuan e filluan atë si një projekt të vogël, duke e testuar fillimisht në chatbots e tyre mes një audience relativisht të rehatshme, dhe aspak të përzier. P.sh një prej projekteve u ideua se si të ndihmojmë prindërit të gjejnë kampin veror që i përshatet më mirë interesave të fëmijëve të tyre, etj. si këto. Por dilema nuk mbaronte këtu. Ky projekt i ri në fushën e teknologjisë së komunikimit u mendua me kujdes të aplikohet edhe në telefon.

Sot në këtë kohë që po flasim, redaksitë e lajmeve në SHBA kryesisht përdorin chatbots për të nxjerrë titujt kryesorë në gazeta por portalet online, apo qoftë dhe për të kërkuar lloje të veçanta informacioni prej audiencës. Mbrëritja e të tilla platformave nuk shërben vetëm për subjekte që mbulojnë audiencat të mëdha. Ato janë po aq të aplikueshme edhe në redaksi të vogla pa nevojën e përdorimit të një kodi. Ndërsa përdorimi i tyre po bëhet gjithnjë e më i larmishëm, ky mbetet një fakt i pamënjueshëm që newsroom-et do të duhet gjithmonë e më shumë ta konsiderojnë. Ndaj ekspertët

parashikojnë se duhet treguar akoma dhe më shumë kujdes në shqyrtimin dhe komunikimin mbi informacionin që audiencia e pajisur me këtë program të ri mund të japë. A përbën ai një lajm? A është ai një histori? A mund të ndahet me gazetarët e redaksisë? Me sponsorizuesit apo zyrën e marketingut? Gazeta e madhe e që përmendëm më sipër, është aktualisht duke eksperimentuar mbi integrimin e reklamave në mjedisin e chatbot, duke nxitur nevojën për standarde të reja etiketimi (S&L). Së fundi, do duhet të besojmë se ka ardhur një kohë e mirë për teknologjinë e komunikimit. Porca të reja inteligjente duan të vendosin një marrëdhënie më të sigurtë me përdoruesit duke bashkëvepruar në një mënyrë më origjinale. Por pyetja që ekspertët ngrënë në përfundim është: 'Si mund ta bëjmë këtë program që secili në anën tjetër, të ndihet se po i shkruan një miku?' Është fare e thjeshtë, përgjigjen po ata. Për sa kohë që jeni të hapur dhe transparentë në atë që po bëni dhe me kë po flisni... asgjë nuk ju pengon të krijoni një marrëdhënie autentike me tjetrin, edhe kur në mes është diçka që ngjan si artificiale.

ZBULOHEK "RIVALI"



Shqipëria duket se po finlizon edhe kundërshtarin e dytë që do të zhvillojë një miqësore në fundin e muajit maj. Siç raportoi Top Channel, kundërshtari i mundshëm mund të jetë Kosova. Pas ndeshjes miqësore të humbur ndaj Norvegjisë, në "Elbasan Arena", trajneri italian Christian Panuçi kishte njoftuar se kuqezinjtë do të

Miqësorja e majit, në Zvicër do luhet Shqipëri-Kosovë

zhvillojnë një tjetër minifazë përgatitore në Zvicër, e përveç kësaj bëri të ditur se kishin gjetur një kundërshtar, që më pas u mësuat të ishte Ukraina e Andriy Shevçenkos, ndërsa po punohej për rivalin tjetër. Panuçi ndërkohë, pas shortit të ligës së Kombeve, pati deklaruar se në miqësoret e fund-majit, Shqipëria do të luante me dy kundërshtarë që merrnin pjesë në Botëror, gjithsesi, pas ndeshjes me Ukrainën,

duket se Shqipëria do të masë forcat me Kosovën. Tashmë mësohet se presidenti i FSHF-së, Armand Duka ka ngarkuar njerëzit përgjegjës në Federatë me mbylljen e përgatitjeve, në mënyrë që në Zvicër, më 29 maj, Shqipëria të zhvillojë edhe një ndeshje miqësore ndaj pjesës tjetër të kombit shqiptar, Kosovës.

Taulanti "fshin merimangat" nga porta e Jang Bojsave nga rreth 30 metra largësi



Jeton Selimi

Khaka e Vajushi shënojnë eurogola

Por Basha gjithsesi e mposht Armandon

Në javën e 27-të në kampionatin zviceran, është luajtur sfida kryesore mes Jang Bojsit dhe Bazelit. Ky takim ka përfunduar me rezultatin 1-1 pjesën e parë, teksa një gol të mrekullueshëm nga distanca, ka shënuar mesfushori i kombëtares shqiptare, Taulant Xhaka. Futbollisti i Kombëtares ka rikthyer takimin në ekuilibër në minutën e 39-të, duke shantur portierin kundërshtar me një predhë nga distanca. Bazeli ka gjetur avantazhin e përkohshëm me anë të Suchy, ndërsa vendositi kanë barazuar shifrat në minutën e 56-të. Pas këtij barazimi ndërpritet ecuria pozitive e Jang Bojs, që kishin 8 takime radhazi të fituara në kampionat. Kjo skuadër ndodhet në vendin e parë me 16 pikë distancë nga Bazeli, por në këtë sezon kampionati zviceran dërgon 2 ekipe në "Champions League" dhe kjo do ta favorizojë së tepërmi skuadrën e Taulant Xhakës.

BASHA MUND VAJUSHIN

Gjatë ditës së djeshme janë zhvilluar takimet e javës së 33-të në Seria B. Në këto



takime, ajo që ka tërhequr vëmendjen për sportdashësit shqiptarë, ishte takimi mes Avelinos dhe Barit, që ka përfunduar me rezultatin 1-2. Për Avelinon e ka nisur nga minuta e parë Armando Vajushi, ndërkohë nga ana tjetër është aktivizuar edhe Migjen Basha, që ka rolin e kapitenit të skuadrës. Pas një periudhe

negative në karrierën e tij, Armando Vajushi ka arritur të realizojë me fanellën e Avelinos, duke gjetur golin pas shumë kohësh, madje një gol të shkëlqyer, në ndeshjen e parë si titullar me këtë fanellë. Por mesfushori shkodran nuk i ka mjaftuar Avelinos, pasi në pjesën e dytë Bari ka përmbytur gjithçka, duke

REAGON I VËLLAI
Graniti, elozhe Taulantit:
Ti je më i miri

Taulant Xhaka ka arritur të realizojë një supergol nga distanca në takimin që Bazeli ka zhvilluar ndaj kryesuesve të Jang Bojsit. Menjëherë pas këtij goli të realizuar, vëllai i Taulantit, Granit Xhaka ka publikuar një video të veçantë në "Instagram". Në këtë video gjendet goli i realizuar në ditën e sotme nga Taulant Xhaka, i krahasuar me një tjetër perlë të Granitit në "Premier League". Në përshkrimin e saj, Graniti shprehet: "Suksesi në futboll varet nga ajo se çfarë ti mendon. Ti duhet të besosh se je më i miri dhe duhet të sigurosh që është kështu", ka thënë futbollisti i Arsenalit.



Frederik Veseli po dominon këtë vit kampionatin duke bërë thauja një formalitet ngjitjen kur mbeten edhe 8 javë deri në mbylljen e fazës së rregullit. Suksesi i djeshëm me shifrat 3-0 ishte prova e radhës se përbërja e këtij grupi me të drejtë mund të pretendojë të luajë me rregullsi edhe në Serinë A, pas vetëm një viti rënies. Por ndërsa skuadra fiton, shqetësues mbetet situata e Frederik Veselit, i cili ka pësuar një dëmtim dhe mungon prej 5 ndeshjesh në radhë e skuadrës ku kishte luajtur rregullisht si qendërmbrojtës në 25 takime në këtë sezon. Klubi nuk ka bërë të ditur se kur do të kthehet futbollisti i përfaqësueses shqiptare në fushën e lojës, por duke parë formën që po kalon ekipi, edhe nëse kthehet do ta ketë shumë të vështirë që të sigurojë vend në fushën e lojës.

VESELI NË INFIERMIERI

Empoli ka mundur me rezultatin 3-0 skuadrën e Foxhias në Serinë B, duke bërë një tjetër hap para drejt ngjitjes në elitën e futbollit italian. Skuadra e

CHAMPIONS LEAGUE

Klop: Guardiola i zoti si unë, por merr ekipe më të mira

Një nga duelet më entuziazmes të çerekfinaleve të Ligës së Kampioneve është padyshim ai mes Liverpoolit dhe Manchester Sityt, një sfidë tërësisht angleze që vë përballë edhe dy trajnerë shumë të fortë si Jurgen Klop dhe Pep Guardiola. Sipas trajnerit gjerman, të dy janë njëjloj, por spanjollit kishte fatin se në karrierë kishte drejtuar gjithmonë skuadra më të forta se ai, ndaj përballjet nuk kishin qenë asnjëherë të barabarta që në fillim. "Në stilin e lojës nuk ka shumë ndryshime, të themi të drejtën. Por ekziston fakti se Pep ka pasur gjithmonë skuadra më të forta se ato që kam drejtuar unë! Mund ta shihni tani që ka një avantazh shumë të madh ndaj nesh me Manchester Sityn, por tani distanca, në fakt, është shumë më e vogël se sa kur ai ishte në drejtimin e Bajernit dhe unë të Borussia Dortmund", deklaroi Klop, duke lënë të kuptohet se tani po i afrohet gjithnjë e më shumë spanjollit me shpresën që ta kalonte.

CHAMPIONS	
TË MARTËN	
Juventus - Real Madrid	20:45
Sevilja - Bajern Mynih	20:45
TË MËRKURËN	
Barcelona - Roma	20:45
Liverpul - Manchester Siti	20:45

"RUSI 2018"

Kërcënime para Botërorit, ISIS përgatit sulmin me dron për anglezët

Ekstremistët e ISIS kanë kërcënuar përsëri botën e futbollit. Në një postim në aplikacionin Telegram qarkullon një video ku thuhet se detajohet sulmi mbifitozë anglezë. Sulmet tregohen se do të bëhen me dron. Një tjetër video tregon një dron që mban një raketë anti-tank. Është e rrezikshme, në fakt, se këto video janë ngarkuar në YouTube dhe të gjithë mund të mësojnë si t'i prodhojnë. Vladimir Putin është vënë vet në lëvizje me anë të drejtorit të shërbimit sekret. Ndërkohë edhe asistenti i tij është në krye të operacionit që do të sigurojë gjithë mbarëvajtjen e Kupës së Botës.




YLLI I FUTET POLITIKËS

Eto synon të bëhet president i Kamerunit

Ylli kamerunas Samuel Eto, është një ndër futbollistët më të suksesshëm afrikanë, pasi ka arritur të fitojë shumë trofe me disa nga ekipet ku ka luajtur. Sulmuesi 37-vjeçar, aktivizohet aktualisht me Koniasportin në Turqi dhe mesa duket, ai po mendon tërheqjen nga futbollit, pas një karriere të mbushur me suksese. Ndërsa nga futbollistët e tjerë, të cilët ndjekin rrugën e trajnerit, Eto po mendon për të kandiduar në zgjedhjet presidenciale që do të mbahen në Kamerun. Ka qenë vetë sulmuesi, ai që ka pranuar mundësinë për të kandiduar duke u shprehur se është njeriu i duhur për të ndihmuar Kamerunin që të dalë nga situata e vështirë në të cilën ndodhet. Kjo nuk është hera e parë që një futbollist kandidon për president në kontinentin afrikan, pasi më parë, legjenda e Milanit, Xhorxh Uah është zgjedhur president i Liberisë.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL


1. Niven që qe aktor.
5. Little... kryeqyteti i Arkansas.
7. Janë tek në lakër.
10. Nuk ka akoma një bebe.
11. Kufizojnë katete.
12. Penn aktor.
13. Hector që shkroi Pa familje.
15. Thahen me bonifikime.
18. Mbyllin takimin.
19. Ndërmarrje Industriale Mat.
21. Mbyllën me epilog.
23. Tregohen indiferentë dhe aspak të gjallë.
25. Ishin sandalet e lëkurëkuqve.
27. Njëlljo për latinët.
30. Eshhtë vend si Katari.
31. Pupi regjisor.
32. Janë strehat e çobanëve.
33. Eshhtë centrali si Chernobyl.
35. Fillojnë një argument.

36. Të parat në stadium
37. Mund të sjellin shi.
38. Kështu fillon Odisea.
39. Një mund të jetë emërore.
42. Thirrej edhe kështu Persefoni.
44. Ai dhe ajo.
45. E ka lënë atë që s'ka fuqi
48. Para es Salaam.
49. Ylli i Londrës.
50. Eshhtë syzë... në komo.

VERTIKALI

1. Hyskja aktor.
2. Kush e thotë lutet.
3. Një tis mjegulle.
4. Maiden që këndojnë.
5. Gjysmë rekord.
6. Antonio skulptor i famshëm.
7. David regjisor.
8. Janë brijnë në skuadër.
9. Ruan në kufij.
12. Mban mikrofonin.
14. Janë edhe ato të fytyrës.
16. Qureshin edhe Eumenide.
17. Demek pa kufij.
20. Mund të jetë atomike.
22. Qyteti i përjetshëm.
24. Kitara e Ravi Shankar.
25. Janë katrore në sipërfaqe.
26. Një fjalë si goja.
28. Pak daktilografi.
29. Eshhtë si divan.
31. Një pjesë e amerikanëve.
32. Bernhardt që qe aktore.
34. Eshhtë infeksion në veshë.
38. Një mund të jetë unik
40. Gjysma e sasisë.
41. Pak marramendëse.
43. Eshhtë dhomë.
45. Fillojnë takimin.
46. Në fund majtas.
47. Të fundit në manastir.

Fjalëkryqi (2)



HORIZONTAL


1. E bardhë ajo Moby Dick.
5. Fillojnë amplifikimin.
7. Eshhtë vit që parashikohet.
10. Mbyllin pamjen.
11. U printe jeniçerëve.
13. Thurman aktore.
14. Një reaksion në provëz.
16. Një sport me brez të zi.
19. Në fund të fundit.
20. Janë në gjyq.
23. I është hequr të dënuarit.
24. Eshhtë shahu i fundit
25. Janë fletë trëndafili.
27. Kufizojnë një metër.
28. Tregojnë pallate në miniaturë.
29. Një fjalë pa shkak.
30. Janë përlogaritje.
32. Mbyllin një dritare.
33. Të parat në muzg.

34. Me të nxjerrin një letër.
35. Janë me ngjyra të tilla si tunxhi.
37. Toromani balerinë.
39. Inicialet e Reitman regjisor.
40. Fillojnë politikën.
42. Një piktor si Antonio Ligabue.
44. Diftong në dietë.
46. Një lind në kokë.
48. Kush ka... do të pijë.
49. Punojnë në galeri.
52. Fillojnë titrat.
53. Mund të jetë ekspres.
54. Mund të skadojë.


VERTIKALI

1. Ishite titulli i Hiro Hitos.
2. Ekberg aktore.
3. Eshhtë skuadra.
4. Dy asa.
5. Binjaket në klasa.
6. Qe duhet sajdusur.
7. Nuk i bihet me kokë.
8. Sharif aktor.
9. Janë organet e taksave.
12. Me Haensel në përallat e vëllezëve Grimm.
15. Vihen për të mbyllur.
17. Janë vegla.
18. Eshhtë medalja e të parit.
21. I dhimbset frikacakut.
22. Mund të jetë mbi xhiro.
26. Eshhtë llahtar.
28. Janë inate të akumuluar
30. Eshhtë vëlla i graus.
31. Një tip për të kërcyer.
33. Edoard piktor.
36. Lumë në Francë.
38. Janë djemtë e... nënës.
41. Lindi Akilin.
43. Kodi i celularit.
45. Mbledh basketë separatistë
47. Një është edhe Egjeu.
49. Fillojnë një metodë.
50. Dy anët e një neni.
51. Fillojnë ofensivën.

Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)

SUDOK

	4	8				6	5
			8	5	7		9
		2	7			1	3
8				7		3	
	3	9	1		4	6	7
	5		6				2
3	7			1		9	
1		6	5	4			
9	2					4	8

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar



9	5	7	8	6	3	2	1	4
2	1	6	7	5	4	9	8	3
4	3	8	1	2	9	5	6	7
6	4	2	9	7	1	3	5	8
8	7	3	6	4	5	1	2	9
1	9	5	2	3	8	7	4	6
5	8	1	4	9	7	6	3	2
3	6	9	5	8	2	4	7	1
7	2	4	3	1	6	8	9	5

Argëtim filozofik

- Eshhtë më mirë ti meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa ti gëzoni dhe të mos i meritoni. (Mark Tueni)
- Bota është një anije mbi të cilën jemi të gjithë pasagjerë: nuk duhet të lejojmë që ajo të mbytet. (Mikhail Gorbaçov)
- Pjekuri do të thotë të dish të bësh gjëra, për të cilat nuk na kontrollojnë askush: të kesh lekë në xhеп dhe të mos i shpenzosh ato, të të bien në qafë dhe të mos duash të hakmerresh. (Anonim)

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm



Thënie të mënçura

- Mendo më pak, se çfarë mendojnë të tjerët për ty, dhe më shumë, se çfarë mendon ti për ata. Fay Weldon
- Ruajti shoqet siç ruan pikturat, dhe vendosi ato nën dritën më të mirë. Jennie Jerome Churchill
- Njeriu kur ndjen dhimbje, është i gjallë... Por kur ndjen dhimbjen e tjetrit, atëherë është NJERI.
- Forca shpirtërore s'është gjë tjetër, veçse arti për të mbajtur mbyllur në zemër shoqësimin.
- Nuk ka rëndësi kush të zhgënjue, apo kush të rrezoi, rëndësi ka kush të bëri të buzëqeshësh sërish.

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL



- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

